Activity supported by the
Canada Fund for Local Initiatives

Activité réalisée avec l'appui du
Fonds canadien d'initiatives locales

Canada

Australian Aid
Supported by the Australian Government

MARTESË NË GJYKATË? TË DREJTAT E FËMIJËVE, MARTESA NËN MOSHË DHE ROLI I GJYKATËS

RAPORTI 2

Raport mbi aspektet ligjore, sociale dhe praktikën gjyqësore të martesave nën moshë në Shkodër, Kukës, Tropojë, Lezhë, Pukë, Fier dhe Kavajë për periudhën 2011 - 2017

TIRANË, QERSHOR 2018

Activity supported by the
Canada Fund for Local Initiatives
Activité réalisée avec l'appui du
Fonds canadien d'initiatives locales

Canada

Australian Aid
Supported by the Australian Government

MARTESË NË GJYKATË? TË DREJTAT E FËMIJËVE, MARTESA NËN MOSHË DHE ROLI I GJYKATËS

RAPORTI 2

Raport mbi aspektet ligjore, sociale dhe praktikën gjyqësore të martesave nën moshë në Shkodër, Kukës, Tropojë, Lezhë, Pukë, Fier dhe Kavajë për periudhën 2011 - 2017

TIRANË, QERSHOR 2018

Ky raport hartohet në kuadrin e zbatimit të projektit *"Zbatimi i mekanizmave ligjore si një mjet për parandalimin e martesave nën moshë".*

Projekti është zbatuar nga ***Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori),*** përmes monitorimit të vendimeve gjyqësore për periudhën 2011- 2017 përkatësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor (GjRrGj) në *Shkodër, Kukës, Tropojë, Lezhë, Pukë, Fier dhe Kavajë.* Fondi Kanadez për Nismat Lokale (CFLI) dhe Qeveria Australiane përmes departamentit të punëve të jashtme dhe tregtisë, kanë mbështetur financiarisht këtë projekt.

Autor:
Prof. Dr. Arta Mandro – Balili, - Analiza Ligjore e vendimeve të Gjyqësorit

Supervizoi:
Elma Tërshana

Menaxhoi:
Eridjona Vallja

© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky raport duhet të dërgohen në:
Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
Blv. Bajram Curri, Nd. 136, H.14, Ap. 1,
Njësia Administrative nr 5, 1019, Tiranë
Tel: 00355 42 258 987
Email: info@observator.org.al
Webmail: www.observator.org.al

Ky raport është financuar nga Fondi Kanadez për Nismat lokale dhe Qeveria Australiane përmes Departamentit të Punëve të Jashtme dhe Tregtisë.
"Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe jo domosdoshmërisht paraqet opinionin e Fondit Kanadez për Nismat Lokale dhe Qeverisë Australiane."

Tabela e Përmbajtjes

i. Lista e shkurtimeve..... 6

ii. Lista e grafikëve..... 7

iii. Lista e tabelave..... 8

iv. Falënderime..... 9

v. Mbi Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve..... 11

vi. Përmbledhje ekzekutive..... 13

vii. Hyrje..... 17

I - Analiza Ligjore e vendimeve të Gjyqësorit lidhur me kërkesat me objekt lejimin e lidhjes së martesës nën moshë 21

1. Gjetje kryesore nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të GjRrGj Shkodër, Kukës, Lezhë, Pukë, Kavajë, Fier, Tropojë me objekt 'lidhje martese nën moshë' për periudhën 2011-2017..... 21

1.1 Të dhëna të përgjithshme lidhur me çështjet me objekt "lejim lidhje martese nën moshë" 21

1.2 Forma e kërkimit në gjykatë: kërkesë kundrejt kërkesë padisë ...24

1.3 Gjinia e personit për të cilin/ën kërkohet lidhja e martesës nën moshë 25

1.4 Subjekti kërkues për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë. Marrëdhënia e subjektit kërkues me të miturin/ën në rastet kur kërkesa nuk bëhet prej të miturit/ës: legjitimimi aktiv 25

1.5 Mosha e personit për të cilin/ën kërkohet lidhja e martesës nën moshë 29

1.6 Arsimimi i personit për të cilin/ën është bërë kërkesa dhe jepet vendimi për lidhjen e martesës nën moshë 31

1.7 Vendbanimi i personit të mitur ose kërkuesit jo të mitur në çështjet e lejimit të lidhjes së martesës nën moshë 32

1.8 Numri i seancave dhe kohëzgjatja e procesit gjyqësor 33

2. Pjesëmarrësit në proces 34

2.1 Zyra e gjendjes civile dhe personi madhor me të cilin po lidhet martesa 34

2.2 Roli/pjesëmarrja e psikologut 34

2.3 Roli i prindërve dhe shoqërimi i të miturit/ës në gjykatë nga të rritur të tjerë 35

2.4 Prania e mbrojtësit ligjor/Avokatit 35

3. Përmbajtja e vendimeve gjyqësore 36

3.1 Shkaku me rëndësi sipas kërkesës kundrejt shkakut me rëndësi sipas vendimit të gjykatës 36

3.2 Vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës në vendimin e gjykatës 37

3.3 Vlerësimi i pjekurisë fiziko-psikike të të miturit dhe kuptimi i qartë i martesës 38

3.4 Vlerësimi nga ana e të miturit/ës për të kuptuar qartë martesën dhe gadishmëria e të miturit për të marrë përgjegjësi 39

II - Analiza sociale e rasteve të martesave nën moshë 40

1. Analizë e gjetjeve me aspekt shoqëror në lidhje me martesat nën moshën e lejuar në Shkodër, Kukës, Lezhë, Tropojë, Pukë, Fier dhe Kavajë 40

1.1 Karakteristikat demografike sipas hulumtimit në Shkodër, Kukës, Tropojë, Lezhë, Pukë, Fier dhe Kavajë 40

1.2 Karakteristikat e historikut arsimor të grave të martuara nën moshë 45

1.3 Jeta familjare dhe statusi shoqëror i grave të martuara nën moshën 47

1.4 Arsyet e martesave nën moshë dhe lidhjes ligjore 49

1.5 Shkaku me rëndësi i vendimit të gjykatës 51

III. Shqetësimet kryesore për martesat nën moshë 52

IV. Përmbledhje e rekomandimeve kryesore. Udhëzues për gjykatën në shqyrtimin e kërkesave me objekt 'lejimin e lidhjes së martesës nën moshë' 54

V. Bibliografia 58

Shtojca A: Vendimet gjyqësore 59

i. **Lista e shkurtimeve**

CEDAW	Konventa Për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
CFLI	Fondi Kanadez për Nismat Lokale
GjRrGj	Gjykata e Rrethit Gjyqësor
ILF	Interesi më i Lartë i Fëmijës
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
KF	Kodi i Familjes miratuar me Ligjin Nr.9062/8.5.2003
Observatori	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

ii. **Lista e grafikëve**

Grafik 1: Çështjet e paraqitura për periudhën 2011-2017 në GjRrGj Shkodër, Kukës, Tropojë, Lezhë, Pukë, Fier, Kavajë 22

Grafik 2: Përqindja e kategorisë së subjektit kërkues në vendime 27

Grafik 3: Përqindja e kohëzgjatjes së çështjeve nëpërmjet seancave gjyqësore..... 33

Grafik 4: Shkaku me rëndësi sipas kërkesës në Gjykatë .. 36

Grafik 5: Mosha aktuale e të intervistuarve sipas anketimit ... 41

Grafik 6: Mosha e nënës kur ka lindur fëmijën e parë sipas anketimit 42

Grafik 7: Niveli i arsimimit të anketuarave..... 46

Grafik 8: Shkollimi pas lindjes së fëmijës..... 46

Grafik 9: Shkaqet e martesës nën moshë..... 50

Grafik 10: Shkaku për lejimin e martesës nga Gjykata..... 51

iii. **Lista e tabelave**

Tabelë 1: Totali i kërkesave për lejim martese nën moshë sipas rretheve dhe viteve..... 21

Tabelë 2: Subjekti kërkues në kërkesat me objekt lejimin e martesës nën moshë sipas rretheve..... 26

Tabelë 3: Grupmosha e të miturës në kërkesat me objekt lejimin e martesës nën moshë 30

Tabelë 4: Përqindja e rasteve sipas diferencës në moshë midis të miturës dhe bashkëshortit të ardhshëm në kërkesat me objekt lejimin e martesës nën moshë 31

Tabelë 5: Interesi më i lartë i fëmijës në vendimet gjyqësore.... 37

Tabelë 6: Mosha e martesës së të intervistuarave sipas anketimit 41

Tabelë 7: Statusi i martesës sipas anketimit 43

Tabelë 8: Mosha e prindërve të vajzave në martesë nën moshë sipas anketimit 44

Tabelë 9: Lloji dhe statusi i familjeve ku janë rritur të anketuarat 44

Tabelë 10: Statusi i punësimit të prindërve të të miturave 45

Tabelë 11: Arsimimi prindëror 46

Tabelë 12: Vitet e jetesës me familjen e bashkëshortit 47

Tabelë 13: Numri i fëmijëve të lindur pas fëmijës së parë 48

Tabelë 14: Gjendja shëndetësore e fëmijëve sipas vlerësimit mëmësor 48

Tabelë 15: Problematika gjinore 49

Tabelë 16: Gjendja emocionale gjatë intervistimit 50

iv. **Falënderime**

Ky raport hartohet në kuadrin e zbatimit të projektit *"Zbatimi i mekanizmave ligjore si një mjet për parandalimin e martesave nën moshë"*, zbatuar nga ***Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori)***.

Observatori në bashkëpunim me ***Shkollën e Magjistraturës*** kanë monitoruar vendimet gjyqësore për periudhën 2011 - 2017 përkatësisht në 7 Gjykata të Rretheve Gjyqësor (GjRrGj) *Shkodër, Kukës, Tropojë, Lezhë, Pukë, Fier dhe Kavajë*. ***Fondi Kanadez për Nismat Lokale (CFLI)*** dhe ***Qeveria Australiane*** përmes departamentit të punëve të jashtme dhe tregtisë, kanë mbështetur financiarisht këtë projekt.

Dëshirojmë të falënderojmë CFLI dhe Qeverinë Australiane që financuan monitorimin e vendimeve të gjykatave si dhe përgatitjen e këtij raporti. E gjithë kjo nismë synon evidentimin e problematikës së praktikës gjyqësore dhe marrjen e masave të përshtatshme nga ana e sistemit të drejtësisë lidhur me fenomenin e martesave nën moshën 18 vjeç.

Observatori shpreh falënderimet dhe mirënjohjen ndaj Z. Sokol Sadushi Drejtor i Shkollës së Magjistraturës, si dhe stafin administrativë të këtij institucioni për bashkëpunimin profesional.

Observatori shpreh falënderimet dhe mirënjohjen ndaj Z. Arben Zefi Kryetar i GjRrGj Shkodër, Z. Isuf Shehu Kryetar i GjRrGj Kukës, Z. Dritan Seci Kryetar i GjRrGj Tropojë, Znj. Ornela Naqellari Kryetare e GjRrGj Lezhë, Z. Izet Kadana Kryetar i GjRrGj Pukë, Z. Roland Jaupaj Kryetar i GjRrGj Fier, Znj. Entela Shedula (Sorra) Kryetare e

GjRrGj Kavajë, si dhe stafet administrative të këtyre gjykatave për gadishmërinë në dhënien e çdo informacioni lidhur me praktikën gjyqësore me objekt kërkesat për lidhjen e martesës nën moshë dhe për gjithë lehtësitë e krijuara në këtë proces.

Observatori dëshiron të shprehë mirënjohjen e veçantë dhe falënderimet e përzemërta për Prof.Dr Arta Mandro e cila hartoi tabelat, lëhtësoi kontaktet me gjykatën dhe përgatiti analizën ligjore të vendimeve të gjyqësorit në këtë raport. Falënderime shkojnë dhe ekspertët e Observatorit, që kontribuan në analizën sociale të martesave nën moshë.

Observatori shpreh falënderimet e sinqerta për ekipin e kësaj nisme edhe të monitoruesve të përbërë nga: Znj. Elma Tërshana, Znj. Eridjona Vallja, Znj. Albana Kastrati, Z. Shkëlqim Muça, Z. Marian Ndoci, Znj. Migena Vallja dhe Znj. Dafina Muda.

Observatori shpreson që gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e këtij raporti të jenë të dobishme dhe të gjejnë vend në zbatimin e tyre në praktikën gjyqësore dhe ndërgjegjësimin qytetar lidhur me rastet e martesave nën moshë si dhe do të nxisin angazhim edhe më të gjerë prej aktorëve të tjerë.

v. **Mbi Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve**

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori) është një entitet jo-fitimprurës shqiptar i themeluar në vitin 2013, me misionin e sigurimit të dinjitetit dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve në të gjithë vendin nëpërmjet vëzhgimeve, kërkimeve dhe analizave, komunikimeve dhe advokacisë; duke bashkëpunuar me aktorët kyç dhe institucionet; duke u angazhuar në fushata ndërgjegjësuese dhe edukuese. Observatori me 12 zyra (një për çdo rajon të vendit), nga nivel lokal në atë kombëtar, mbledh të dhëna, shkëmben informacione, ngre debate, përdor metoda dhe programe inovatore, - për të kontribuar në ndërtimin e një vendi ku çdo fëmijë dhe i ri jeton me dinjitet dhe është i mirëshërbyer nga institucionet shtetërore. Rreth veprimtarisë së Observatorit mund të njiheni në faqen: www.observator.org.al

Observatori kontribuon për të prodhuar dhe për të përdorur prova shkencore për formulimin e politikave të bazuara tek rezultatet dhe të qendërzuara tek të drejtat e fëmijës. Observatori monitoron zbatimin e politikave kombëtare për mirëqenien e fëmijëve dhe të të rinjve, duke i'u referuar standardeve dhe politikave kombëtare dhe ndërkombëtare.

Observatori ka kontribuar ndër vite mbi çështjen e martesave nën moshë duke tërhequr vëmendjen dhe interesin e institucioneve ndërkombëtare dhe kombëtare. Martesa nën moshë është një fenomen, i cili është pjesë e shumë shoqërive në zhvillim, duke ardhur kryesisht si pasojë e traditave dhe kulturës. Për rrjedhojë Obsevatori ka shtrirë analizën nga komunitetet specifike, zonat e caktuara e deri tek rastet e legjitimimit të martesave nën moshë nga Gjykatat shqiptare.

Studimet e realizuara nga Observatori mbi martesat nën moshë janë:

- Studimi i parë *"Martesat e hershme në Shqipëri, një vështrim specifik i komunitetit Rom"* u realizua përgjatë periudhës Janar - Mars 2015 dhe u pilotua në 3 zona të Tiranës: Shkozë, Liqen dhe Qendra e Emergjencave. Versioni elektronik i studimit mund të gjendet në faqen zyrtare të Observatorit: http://observator.org.al/wp-content/uploads/2015/03/2015-Martesat_e_hershme_ne_Shqiperi.pdf

- Studimi i dytë *"Zgjendrra e Lumturisë së Martesës së Hershme: Raste Studimore për Martesën e Hershme në Korçë dhe Vlorë"* u realizua në zonat e Korçës dhe Vlorës, duke e shtrirë fokusin e kësaj çështjeje në zonat rurale. Versioni elektronik i studimit mund të gjendet në faqen zyrtare të Observatorit: http://observator.org.al/wp-content/uploads/2016/02/ZEB_Studimi_al_12Shk2016.pdf

- Studimi i tretë *"Martesë në Gjykatë? Të drejtat e fëmijëve, martesa nën moshë dhe roli i gjykatës. Raport mbi aspektet ligjore, sociale dhe praktikën gjyqësore të martesave nën moshë në Korçë dhe Pogradec për periudhën 2011 – 2016"* u realizua nëpërmjet monitorimit të vendimeve gjyqësore në Gjykatat e Korçës dhe Pogradecit. Versioni elektronik i studimit mund të gjendet në faqen zyrtare të Observatorit: http://observator.org.al/wp-content/uploads/2017/03/Raporti-martesat-nen-moshe_al.pdf

vi. **Përmbledhje ekzekutive**

Ky raport analizon aspektet ligjore dhe sociale të martesave nën moshë në Shqipëri. Raporti fokusohet në evidentimin dhe analizën e *vendimeve gjyqësore* të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore (GjRrGj) *Shkodër, Kukës, Tropojë, Lezhë, Pukë, Fier dhe Kavajë për periudhën 2011- 2017*. Raporti është kryer në kuadrin e projektit "Zbatimi i mekanizmave ligjore si një mjet për parandalimin e martesave nën moshë", me mbështetjen e Fondit Kanadez për Nismat Lokale (CFLI) dhe Qeverisë Australiane. Monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt kërkesat për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë është realizuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori) në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës.

Ky raport evidenton problematikën e praktikës gjyqësore dhe marrjes së masave të përshtatshme nga ana e sistemit të drejtësisë lidhur me fenomenin e martesave nën moshën 18 vjeç. Raporti analizon praktikën gjyqësore me objekt kërkesat për lidhjen e martesës nën moshë dhe sesi "martesa nën moshë" ka ndikuar në jetën sociale, familjare të të miturve.

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt lejimin e martesave nën moshë në 7 GjRrGj, përgjatë periudhës 2011 – 2017, rezulton se:

- Janë paraqitur 68 kërkesa për 'lejim lidhje të martesës nën moshë', nga të cilat 82% e kërkesave janë pranuar (56 kërkesa), 16.5% e kërkesave janë pushuar (11 kërkesa) dhe 1.5% e kërkesave janë rrëzuar (1 kërkesë).

- Gjykatat që kanë një numër më të lartë të vendimeve të legjitimuara për lejimin e martesave nën moshë është

GjRrGj Fier (14 raste nga 18 të paraqitura) dhe GjRrGj Shkodër (12 raste nga 14 të paraqitura).

- Pjesa më e madhe e kërkesave për 'lejim lidhje të martesës nën moshë' janë paraqitur në vitin 2011 me 25% të rasteve. Ky fenomen ka ardhur në zbritje në vitin 2017 me 12% të rasteve.

- Në të gjitha vendimet gjyqësore (në 100% të tyre) **është kërkuar lejimi i lidhjes së martesës nën moshë për bashkëshorten e ardhshme dhe në asnjë rast për bashkëshortin e ardhshëm.**

Po si është profili i një vajze të mitur për të cilën kërkohet lejimi i martesës nën 18 vjeç?

- Në lidhje me moshën e të miturave, rezulton se numrin më të madh e zë grupmosha 17 - 18 vjeç me një diferencë të vogël me grupmoshën nën 17 vjeç. Janë 5 vendime ku mosha e të miturës është nën 16 vjeç. Në 3 vendime mosha nuk specifikohet.

- Në lidhje me vendbanimin e të miturës për të cilën po kërkohet lidhja e martesës nën moshë, rezulton se në 70.5% të rasteve ato jetojnë në zonat rurale (48 raste). Ndërsa në 3% të rasteve ato jetojnë jashtë shtetit, konkretisht në SHBA dhe Kroaci.

- Për shumicën e rasteve (75%), arsimimi i të miturave nuk del në vendime. Ndërsa në rastet e tjera bëhet fjalë për të mitura me arsim 9 vjeçar (18% të rasteve) dhe në 7% të rasteve të miturat janë me arsim të mesëm.

Me kë martohen vajzat e mitura?

- Nga analiza e gjithë vendimeve gjyqësore rezulton se mosha e bashkëshortit të ardhshëm varion në kufijtë 19 - 35 vjeç. Në pjesën më të madhe të vendimeve (32% të vendimeve) diferenca në moshë mes të miturës dhe bashkëshortit të ardhshëm është 7-10 vite. Shqetësues janë 4% të rasteve në të cilën diferenca është tepër e lartë, plot 16-19 vite.

- Në 73.5% të rasteve, pretendentët për bashkëshort të ardhshëm jetojnë në Shqipëri, ku pjesa më dërrmuese e tyre jetojnë në fshat (në 40 raste). Ndërsa në 12% të rasteve, pretendentët për bashkëshort të ardhshëm jetojnë jashtë Shqipërisë, konkretisht në Amerikë, Itali, Maqedoni, Kosovë dhe Kroaci.

Çfarë kanë në përmbajtje vendimet gjyqësore?

- *Në 6 vendime gjyqësore është bërë një vlerësim psikologjik* i të miturës dhe në 26 të tjera del qartë se nuk ka patur psikolog të përfshirë në proces. Në 36 vendime nuk është bërë një vlerësim psikologjik i të miturës.

- Në *28 vendime gjyqësore nuk ka përfaqësim të të miturve me avokat* ndërsa në 13 raste ka përfaqësim me avokat. Pjesa tjetër e vendimeve, nuk kanë një të dhënë të qartë lidhur me përfaqësimin ose jo me avokat.

- Në lidhje me shkakun me rëndësi për legjitimimin e kërkesës nën moshë, në shumicën e rasteve (59%) është shtatëzania. Shkaqet e tjera janë: bashkëjetesa, martesa zakonore, ndërtimi i një jete jashtë shtetit/bashkim familjar, lindja e fëmijës. Gjithashtu ka patur vendime në të cilat nuk ka shkak ose thjesht kërkohet lejim martese.

Bazuar në punën e realizuar deri më tani dhe gjetjet e monitorimit, propozojmë që:

- Konsiderata kryesore e gjykatës duhet të jetë mbajtja në vëmendje e interesit më të lartë të të miturit/ës.

- Gjykata është e inkurajuar të marrë mendimin e të miturit/ës **në kushte ku nuk ka asnjë ndikim ndaj tij/saj.**

- Gjykata nevojitet të verifikojë dhe pasqyrojë në vendim pjekurinë fiziko-psikike të personit nën moshën 18 vjeç që bën kërkesë për lidhje martese nën moshë.

- Gjykata nevojitet të verifikojë rëndësinë e motivit/ shkakut

të pretenduar dhe që shoqëron kërkesën për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë.

- Gjykata nevojitet të verifikojë bazueshmërinë e motivit.
- Reduktimi drejt eliminimit të martesave nën 16 vjeç duhet të jetë në vëmendje të gjykatës dhe të bëhet praktikë e saj.
- Gjykata nevojitet të mbajë në vëmendje se, - të miturat me gjendje të vështirë ekonomike janë më të ekspozuara ndaj rrezikut të martesave fiktive apo premtimeve për martesë që përfundojnë në shfrytëzim për prostitucion, trafikim ose çdo lloj forme tjetër abuzimi.

vii. **Hyrje**

Ky monitorim i vendimeve gjyqësore me objekt kërkesat për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë, realizuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori) në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, është një kontribut me vlerë për kauzën e 'interesit më të lartë të fëmijës', për mbrojtjen e institutit të martesës dhe të familjes.

Ka shumë rreziqe që i vijnë fëmijës nëse nuk zhvillohet një proces që mban në vëmendje këtë interes. Janë të pandashme këto analiza me ato që lidhen me mbrojtjen e veçantë që gëzon martesa dhe familja si institute dhe shtylla bazë të çdo shoqërie. Por në raport me interesin më të lartë të fëmijës duket se institutet në fjalë janë në një linjë lidhjeje varësie edhe vertikale edhe horizontale. Por vendosja e përcaktorit 'më i lartë' ose prioritar bën njëherazi diferencën në fillimin dhe fundin e analizës dhe konkluzioneve kur një çështje e lidhur me fëmijën paraqitet përpara sistemit të drejtësisë.

Sistemi i drejtësisë mund të kontribuojë përmes pushtetit të vet, me ose pa dashje, në shkeljen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të fëmijëve si qënie njerëzore me nevoja të veçanta për shkak të zhvillimit të tyre. Kjo nuk duhet lejuar për asnjë rast dhe asnjë arsye.

Në raportin e Komitetit GREVIO për Shqipërinë[1] në paragrafin 43 të tij nënvizohet se: "Një fushë tjetër ku të dhënat e marra nga gjykatat

[1] Raporti Vlerësues i GREVIO-s mbi masat legjislative dhe masa të tjera që i japin efekt dispozitave të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) Shqipëri. GREVIO/Inf (2017) 13 Botuar më 24 Nëntor 2017.

civile do të ndihmonin në parandalimin e dhunës ndaj grave, në veçanti martesat e detyruara, janë ato që lidhen me autorizimet gjyqësore për të lejuar lidhjen e martesave të të miturve. Iniciativa që synojnë grumbullimin e këtyre lloj të dhënash janë kryer nga OJF-të dhe kanë rezultuar të dobishme në nxjerrjen në pah të çështjeve në fjalë".[2] Gjithashtu, në paragrafin 44 të të njëjtit raport për Shqipërinë, kemi: "GREVIO inkurajon autoritetet shqiptare që të sigurojnë mbledhjen dhe publikimin e të dhënave nga sektori i drejtësisë civile mbi numrin e urdhrave të mbrojtjes, gjininë, moshën dhe marrëdhëniet e të gjitha palëve të përfshira, si dhe mbi autorizimet e dhëna nga gjykatat për martesat me të mitur"[3].

Sipas paragrafit 145 të raportit të Komitetit GREVIO për Shqipërinë kemi gjithashtu këto rekomandime me rëndësi për autoritetet vendase përfshi gjyqësorin: "Duke pasur parasysh rrezikun që paraqesin martesat e fëmijëve në lidhje me mundësinë e martesës së detyruar dhe formave të tjera të dhunës, si trafikimit, GREVIO inkurajon autoritetet që: c. të rishikojë legjislacionin në fuqi me qëllim të futjes së masave mbrojtëse shtesë të përshtatshme, siç është përcaktimi i moshës minimale për të miturit që të jetë në gjendje të kërkojë autorizimin për t'u martuar; d. të hartojë udhëzime që përcaktojnë shqyrtimin gjyqësor të çdo kërkese të

---

2 "Një fushë tjetër ku të dhënat e marra nga gjykatat civile do të ndihmonin në parandalimin e dhunës ndaj grave, në veçanti martesat e detyruara, janë ato që lidhen me autorizimet gjyqësore për të lejuar lidhjen e martesave të të miturve. Iniciativa që synojnë grumbullimin e këtyre lloj të dhënash janë kryer nga OJF-të dhe kanë rezultuar të dobishme në nxjerrjen në pah të çështjeve në fjalë".

3 Ky raport ka shfrytëzuar si referencë rezultatet e bazuara në monitorimin e vendimeve gjyqësore të GjRrGj Korçë dhe Pogradecit për periudhën Janar 2011 – Dhjetor 2016 sipas studimi të bërë nga Arta Mandro-Balili, Bernard Zeneli (2017), Martesë në Gjykatë? –Të drejtat e fëmijëve, martesat nën moshë dhe roli i Gjykatës, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, Tiranë. "GREVIO inkurajon autoritetet shqiptare që të sigurojnë mbledhjen dhe publikimin e të dhënave nga sektori i drejtësisë civile mbi numrin e urdhrave të mbrojtjes, gjininë, moshën dhe marrëdhëniet e të gjitha palëve të përfshira, si dhe mbi autorizimet e dhëna nga gjykatat për martesat me të mitur."

një të mituri që kërkon autorizimin për të lidhur martesën dhe të trajnojë në përputhje me rrethanat gjyqësorët; e. të sigurojë që çdo rishikim i tillë të kryhet në bazë të një bashkëpunimi të ngushtë midis gjykatave dhe mekanizmave ekzistues për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të tilla si njësitë e mbrojtjes së fëmijëve të vendosur në nivel vendor"[4].

Komiteti CEDAW gjithashtu është i shqetësuar për Shqipërinë. Veçanërisht për praktika të tilla të dëmshme si martesa e fëmijëve, zgjedhja e bashkëshortit nga familja dhe pagesa e një çmimi ose prike për nusen, një fenomen ky që është mbizotërues në zonat rurale dhe të largëta dhe në radhët e komuniteteve të vogla. Ky Komitet rekomandon të ndalohen të gjitha praktikat e dëmshme, ku përfshihen martesa e fëmijëve, praktika e familjeve që zgjedhin bashkëshortin për vajzën e tyre. Komiteti është i shqetësuar seriozisht për praktikën e martesës së fëmijëve, i vënë re veçanërisht në mesin e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, shpesh të autorizuar me vendim gjykate si një përjashtim nga mosha minimale e lejuar 18 vjeç për martesë. CEDAW kërkon që të ndalohen rreptësisht martesat e fëmijëve, duke lejuar vetëm përjashtime të kufizuara dhe të përcaktuara qartë për rastet kur gjykatat mund të autorizojnë bashkimet nën moshën 18-vjeçare me pëlqimin e të dy partnerëve, të dënohen shkeljet e këtij ndalimi, dhe të rritet ndërgjegjësimin në mesin e fëmijëve, prindërve, komunitetit dhe publikut të gjerë mbi ndikimin negativ që ka martesa e fëmijëve për shëndetin dhe

[4] Duke pasur parasysh rrezikun që paraqesin martesat e fëmijëve në lidhje me mundësinë e martesës së detyruar dhe formave të tjera të dhunës, si trafikimit, GREVIO inkurajon autoritetet që: c. të rishikojë legjislacionin në fuqi me qëllim të futjes së masave mbrojtëse shtesë të përshtatshme, siç është përcaktimi i moshës minimale për të miturit që të jetë në gjendje të kërkojë autorizimin për t'u martuar; d. të hartojë udhëzime që përcaktojnë shqyrtimin gjyqësor të çdo kërkese të një të mituri që kërkon autorizimin për të lidhur martesën dhe të trajnojë në përputhje me rrethanat gjyqësorët; e. të sigurojë që çdo rishikim i tillë të kryhet në bazë të një bashkëpunimi të ngushtë midis gjykatave dhe mekanizmave ekzistues për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të tilla si njësitë e mbrojtjes së fëmijëve të vendosur në nivel vendor".

zhvillimin e tyre, e veçanërisht për vajzat[5].

Duke cituar këto paragrafë të shkëputur të raportit më të fundit të GREVIO dhe CEDAW kam vlerësim të veçantë për punën e Observatorit që është në avangardë dhe paraprin realizimin e ndërhyrjeve të bazuara mbi studim real të situatave jetësore, ligjore dhe gjyqësore lidhur me fenomenin e martesës nën moshë. Një kontribut me vlerë për cdo fëmijë dhe për gjithë sistemin.

Ky raport i shtohet atij të përgatitur nga monitorimi i vendimeve të GjRrGj Korçë e Pogradec dhe botuar nga Observatori në vitin 2017[6]. Është zbatuar e njëjta metodologji dhe janë identifikuar pothuajse të njëjtat probleme. Kjo tregon se ndërhyrjet në disa nivele, ligjore dhe ndërgjegjësuese, janë dhe mbeten ende me shumë rëndësi.

[5] Cedaw/CALB/CO/4, 25 July 2016. Shih për më shumë: Komiteti vlerësoi raportin e katërt periodik të Shqipërisë (CEDAW/C/ALB/4) në seancën e 1413-të dhe 1414-të, më 12 korrik 2016 (shih CEDAW/C/SR.1413 dhe 1414). Lista e Komitetit me çështjet dhe pyetjet e ngritura janë përfshirë në CEDAW/C/ALB/Q/4 dhe përgjigjet e Shqipërisë janë përfshirë në CEDAW/C/ALB/Q/4/Add.1.

[6] Shih raportin në: http://observator.org.al/wp-content/uploads/2017/03/Raporti-martesat-nen-moshe_al.pdf

I - Analiza Ligjore e vendimeve të Gjyqësorit lidhur me kërkesat me objekt lejimin e lidhjes së martesës nën moshë

1. *Gjetje kryesore nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të GjRrGj Shkodër, Kukës, Lezhë, Pukë, Kavajë, Fier, Tropojë me objekt 'lidhje martese nën moshë' për periudhën 2011-2017*

1.1 Të dhëna të përgjithshme lidhur me çështjet me objekt 'lejim lidhje martese nën moshë'

Për periudhën 2011-2017, në gjykatat e monitoruara kërkesat e paraqitur me objekt 'lejim lidhje të martesës nën moshë' kanë qënë të ndryshme nga njëra gjykatë në tjetrën. Numri në total i kërkesave të paraqitura është 68. Vihet re se numrin më të madh të tyre e gjejmë në GjRrGj Fier me 18 çështje; Kukës me 13 çështje, Shkodër me 12 çështje dhe Tropojë me 11 çështje. Tabela në vijim përfshin klasifikimin e këtyre kërkesave sipas gjykatave dhe viteve të monitoruara, duke i marrë çështjet në total dhe jo ndarë në çështje të pranuara ose jo.

Viti/rrethi	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Total
Shkodër	2	4	6	1	1	0	0	14
Kukës	1	1	1	3	3	1	3	13
Lezhë	3	0	0	2	0	0	0	5
Pukë	0	0	0	0	0	0	0	0
Kavajë	3	1	1	1	0	1	0	7
Fier	5	2	3	1	3	0	4	18
Tropojë	3	2	1	0	1	3	1	11
Total	**17**	**10**	**12**	**8**	**8**	**5**	**8**	**68**

Tabelë 1: Totali i kërkesave për lejim martese nën moshë sipas rretheve dhe viteve

Kjo tabelë përmbledhëse tregon nga pikëpamja sasiore rastet e paraqitura në gjykatat e monitoruara. Leximi i saj duhet bërë përmes vëmendjes së fluksit të çështjeve brenda një gjykate nga njëri vit në

tjetrin, brenda një viti për të gjitha gjykatat dhe në raport mes gjykatave të ndryshme, për periudhën e analizuar. Kështu për shembull, kërkesat më të shumta sipas viteve duket se janë paraqitur në vitin 2011 me një total prej 17 pasuar nga viti 2013 me totalin prej 12 kërkesash. Vihet re se GjRjGj Fier është shembulli i numrit më të madh të kërkesave për lejim martese nën moshë. Pasohet nga Shkodra, Kukësi dhe Tropoja. Ndërsa dy gjykatat e para hyjnë tek ato 'të mëdha' si nga trupa e gjyqtarëve ashtu edhe çështjeve, vihet re se Tropoja e Kukësi janë gjykata 'të vogla' por me numër jo të vogël kërkesash. Kjo duhet parë në disa drejtime. E para, në drejtim të interesit që ka për të lidhur një martesë sipas ligjit në rastet kur kriteri moshë nuk plotësohet. E dyta, besimi tek martesa si institut dhe roli i gjykatës në lejimin e saj. E treta, që bashkëjetesat nën moshë në formën e 'martesave përmes dasmës' mbeten në hije, por gjithsesi një fenomen ende i pamundura për të vlerësuar të paktën nga ky raport.

Në total, për të gjitha këto rrethe, nga 68 kërkesa të paraqitura në periudhën 2011-17, 56 janë çështje të pranuara dhe 11 janë çështje të pushuara. Ka vetëm 1 çështje të rrëzuar nga GjRrGj Shkodër.[7] Në përqindje kjo do të thotë që 82% e kërkesave janë pranuar. Në këto raste gjykatat kanë arsyetuar se shkaqet e pretenduara janë me rëndësi në çdo kërkesë të paraqitur dhe kështu është lejuar lidhja e martesës nën moshë.



Grafik 1: Çështjet e paraqitura për periudhën 2011-2017 në GjRrGj Shkodër, Kukës, Tropojë, Lezhë, Pukë, Fier, Kavajë

[7] Shih Vendimin nr. 795/23.3.2012 i GjRrGj Shkodër.

Për ***GjRrGj Shkodër*** nga 14 kërkesa të paraqitura në total për lejim lidhje të martesës nën moshë, janë pranuar 12, është pushuar 1 çështje dhe është rrëzuar 1 çështje. Në çështjen e pushuar e mitura rezulton të jetë 16 vjeçe e 5 muaj. Sikurse e thamë, vetëm kjo gjykatë ka një kërkesë të rrëzuar. Shkaku i rrëzimit është paraqitja e kërkesës nga ana e atit të vajzës e cila është nën moshën 18 vjeç. Gjykata ka vlerësuar se ati nuk legjitimohet në këtë kërkesë. Në vendim kemi këto shprehje: "Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën si dhe dëgjoi pretendime përfundimtare ku kërkuesi kërkoi ***që vajza e tij të lidhte kurorë***, dhe si e bisedoi çështjen në tërësi...". Ky vendim nuk ka të dhëna për moshën e saktë të miturës.

Nuk ka asnjë çështje të pushuar ose rrëzuar për ***GjRrGj Kavajë*** në periudhën e monitoruar. Të gjitha kërkesat, janë pranuar. Për ***GjRrGj Kukës***, nga totali 13 ka 3 kërkesa të pushuara si rezultat i mosparaqitjes në gjykim të kërkueses që ka moshën 14 vjeç e 2 muaj dhe në dy raste nuk ka të dhëna për moshën e të miturës. Për ***GjRrGj Lezhë***, nga totali 5 ka një kërkesë të pushuar si rezultat i mosparaqitjes në gjykim të kërkueses e cila është e moshës 16 vjeç e 9 muaj. Për ***GjRrGj Tropojë*** nga 11 kërkesa 2 janë pushuar dhe në këto vendime rezulton se e mitura ka moshën 17 vjeç e 5 muaj dhe 17 vjeç e 8 muaj. Për ***GjRrGj Fier*** nga 18 kërkesa 4 janë pushuar dhe në këto vendime rezulton se e mitura ka moshën 17 vjeç; 15 vjeç e 7 muaj; në një vendim datëlindja është shkruar gabim;[8] dhe në një tjetër 17 vjeçe e 4 muaj.

Nga kontrollim i gjithë vendimeve rezulton se **vetëm në dy raste** të çështjeve të pushuara, kërkesa është riparaqitur. Në një rast të Gjykatës Tropojë në një çështje të pushuar me vendimin nr. 234/3.10.2016, kërkesa është riparaqitur dhe kjo Gjykatë, me vendimin nr. **235**/4.10.2016, pra një ditë më vonë pas dhënies së vendimit për pushimin e çështjes ka lejuar lidhjen e martesës. Në një rast **të Gjykatës Kukës** në një çështje të pushuar me vendimin nr. **65**/21.12.2016, kërkesa është riparaqitur dhe kjo Gjykatë, me vendimin nr. **20**/4.4.2017, pra rreth 4 muaj më vonë pas dhënies së vendimit për pushimin e çështjes ka lejuar lidhjen e martesës.

[8] Shih Vendimin nr.992/14.7.2015 të GjRrGj Fier: datëlindja është shkruar gabim në vendim (është cituar datëlindja 28.06.2015).

Do të ishte me vend që të nënvizonim se në raste të tilla me objekt lejim lidhje martese nën moshë ku çështjet pushohen dhe mandej rikërkohen, gjykata të bënte një hetim më të kujdesshëm mbi vullnetin e të miturës dhe pëlqimin e lirë duke **siguruar seanca pyetjeje pa praninë e të afërmve që mund të influencojnë në vendimmarrje si dhe marrjen e një raporti psikologjik për gjendjen emocionale të miturës dhe mundësinë e imponimit apo shtyrjes në martesë.**

1.2 Forma e kërkimit në gjykatë: kërkesë kundrejt kërkesë padisë

Lejimi i lidhjes së martesës nën moshë është proces që zhvillohet pa palë kundërshtare. Në shumicën e rasteve të monitoruara, 67 nga totali prej 68, vihet re se gjykatat janë vënë në lëvizje përmes kërkesës dhe vetëm në 1 vendim, përkatësisht të GjRrGj Fier[9] gjendet forma e kërkesë padisë. Në këtë vendim me objekt "lidhje martese", çka në formulim duket se nuk është korrekte sepse gjykata nuk është vendi ku lidhet martesa. Ajo lëshon leje ose autorizim, pas verifikimeve të detyrueshme për të lejuar ose jo lidhjen e martesës përpara nëpunësit të gjendjes civile. Në këtë vendim pala paditëse është bashkëshorti i ardhshëm ndërsa palë e paditur është e mitura që sic rezulton nga vendimi duket se ka një moshë rreth 17 vjeçe. Është pak e çuditshme ky pozicionim i palëve dhe mos vëmendja e gjykatës për këtë pasaktësi proceduriale. Gjithsesi rezulton se në seancën përgatitore pala paditëse ka kërkuar tërheqjen 'e kërkesë padisë' dhe të gjithë dokumenteve të paraqitura prej tij çka është pranuar nga ana e gjykatës.

Në një vendim të GjRrGj Tropojë[10] kategoria 'paditës' përdorur në vendim është një çështje e korriguar me atë të 'kërkues' në përmbajtjen e vendimit.

Në këtë mënyrë, mund të konkludojmë se, është kuptuar drejt nga pikëpamja proceduriale paraqitja e një kërkese si mjeti procedurial

[9] Shih Vendimin nr. 964/103/23.7.2015 (është korrigjuar, edhe nuk duket qartë në skanim) të GjRrGj Fier.

[10] Shih Vendimin nr. 234/3.10.2016 të GjRrGj Tropojë.

për të vënë në lëvizje gjykatën.

1.3 Gjinia e personit për të cilin/ën kërkohet lidhja e martesës nën moshë

Në të gjitha vendimet gjyqësore të periudhës 2011-2017, pra 100% të tyre, për GjRrGj Shkodër, Kukës, Lezhë, Pukë, Kavajë, Fier, Tropojë është kërkuar lejimi i lidhjes së martesës nën moshë për bashkëshorten e ardhshme dhe në asnjë rast për bashkëshortin e ardhshëm.

Kështu edhe një herë përsërisim se kërkesa çon më së shumti në ringjalljen, përmes vendimit të gjykatës, të rregullimeve ligjore të shfuqizuara ku martesa lejohej vetëm për gruan 16 vjeçare [Kodi Familjes (KF) 1982]. Ajo që mbetet shqetësuese është se ka raste që kërkohet dhe lejohet martesa edhe për të mitura nën 16 vjeç. Sic do të analizohet në vijim ka martesa të vajzave që sapo i kanë mbushur 15 vjet.

Kështu nga 68 raste në total për të gjitha gjykatat e monitoruara, në 6 raste e mitura ka qënë nën moshën 16 vjeç dhe në 4 raste vendimi nuk përmban të dhëna lidhur me moshën e të miturës[11]. Në disa vendime e mitura sapo ka mbushur 16 vjeç.

1.4 Subjekti kërkues për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë. Marrëdhënia e subjektit kërkues me të miturin/ën në rastet kur kërkesa nuk bëhet prej të miturit/ës: legjitimimi aktiv

Sa i përket kësaj të dhëne situata më e larmishme paraqitet ***në***

[11] Shih Vendimin nr.20/4.4.2017 i GjRrGj Kukës ku e mitura është 15 vjeçe e 10 muaj; Vendimin nr. 118/7.6.2012 i GjRrGj Tropojë ku e mitura është 15 vjeçe e 7 muaj; Vendimin nr.12-2011-739/1.7.2011 i GjRrGj Kavajë ku e mitura është 15 vjeçe e 10 muaj; Vendimin nr. 84/7.4.2014 i GjRrGj Kavajë ku e mitura është 15 vjeçe e 3 muaj; Vendimin nr. 1002/15.7.2015 i GjRrGj Fier ku e mitura është 15 vjeçe e 7 muaj.

GjRrGj Shkodër. Nga 14 kërkesat në total, në 9 prej tyre kërkesa është bërë nga e mitura, në një prej tyre kërkues është nëna dhe babai i të miturës që sëbashku, si prindër i drejtohen gjykatës dhe kërkojnë martesën e vajzës së tyre; në një tjetër vendim është vetëm babai i të miturës, kërkesë kjo e rrëzuar nga gjykata; në një vendim është e mitura dhe prindërit, në një vendim me cilësinë e palës kërkuese është paraqitur prokuroria e rrethit gjyqësor Shkodër.[12] Ky rast i fundit me protagoniste prokurorinë, është një prej rasteve të kërkesave që nuk e kemi hasur në praktikën e asnjë gjykate të monitoruar deri tani përfshi këtu edhe GjRrGj Korçë e Pogradec. Në dy vendime të ndryshme gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodrës është investuar me kërkesë për lejim martese nën moshë. Në rastin e parë është paraqitur kërkesa për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë dhe në të dytin është kërkuar të lejojë lidhjen e martesës pa shpallje. Në këtë gjykatë, pra të Shkodrës, ka edhe një vendim ku kërkues është personi madhor që në rastin konkret është bashkëshorti i ardhshëm i të miturës, sëbashku me të miturën[13].

Rrethi	Vetëm e mitura	Të dy prindërit	Vetëm nëna	Vetëm babai	Vetëm bsh i ardhshëm	Pro-kuroria	E mitura dhe prindërit	Total
Shkodër	9	1	0	1	1	1	1	14
Kukës	6	3	2	1	1	0	0	13
Lezhë	5	0	0	0	0	0	0	5
Pukë	0	0	0	0	0	0	0	0
Kavajë	7	0	0	0	0	0	0	7
Fier	16	0	0	1	1	0	0	18
Tropojë	9	0	0	0	2	0	0	11
Total	52	4	2	3	5	1	1	68

Tabelë 2: Subjekti kërkues në kërkesat me objekt lejimin e martesës nën moshë sipas rretheve

[12] Shih vendimin me nr. 292/6.2.2013 të GjRrGj Shkodër me të cilin është pranuar kërkesa për lidhjen e martesës nën moshë.

[13] Shih Vendimin nr.1068/29.4.2013 të GjRrGj Shkodër.



Grafik 2: Përqindja e kategorisë së subjektit kërkues në vendime

Për GjRrGj Kukës kërkesat për lejim të lidhjes së martesës nën moshë, nga 13 çështje në total, e mitura ka qënë kërkuese në 6 prej tyre. Në një vendim kërkesa është paraqitur nga pretendenti për bashkëshort[14] dhe në 3 rastet e tjera kërkesa është paraqitur nga prindërit e të miturës sëbashku[15] dhe në dy vetëm nga nëna e saj e cila ka zgjidhur martesën me atin e vajzës dhe është ushtruesja kryesore e përgjegjësisë prindërore ndërsa ati ka dërguar një prokurë që e pranon dhe lejon këtë martesë[16].

Për GjRrGj Lezhë dhe Kavajë kërkesat për lejim martese nën moshë janë paraqitur vetëm nga e mitura.

Për GjRrGj Tropojë, nga totali prej 11 kërkesash në 9 prej tyre kërkuese është e mitura ndërsa në 2 raste kërkesa është paraqitur nga pretendenti për bashkëshort të ardhshëm.

Për GjRrGj Fier, nga totali prej 18 kërkesash në 16 prej tyre kërkuese është e mitura ndërsa në 2 raste kërkesa është paraqitur në një rast nga pretendenti për bashkëshort i ardhshëm dhe në një tjetër nga baba i të miturës.

---

14 Shih Vendimin nr.7/14.1.2015 të GjRrGj Kukës.

15 Shih Vendimin nr.20/4.4.2017 të GjRrGj Kukës.

16 Shih Vendimin nr.54/17.10.2017 të GjRrGj Kukës.

Paraqitja e kërkesës nga personi nën moshën 18 vjeç: Çështjet e legjitimimit aktiv të miturit/ës që kërkon të lidhë martesë nën moshë janë përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i Kodit të Procedurës Civile. Pra, gjykata, sikurse është vepruar në shumicën e rasteve, vihet në lëvizje nga e mitura që kërkon të lidhë martesë nën moshë. Ky qëndrim i ligjit dhe i praktikës gjyqësore është plotësisht i justifikuar duke qënë se martesa është një akt personal dhe përfaqësimi në gjykatë nuk do të ishte korrekt. Ashtu sikurse nuk ka lidhje martese me përfaqësim përpara nënpunësit të gjendjes civile, e njëjta vlen për paraqitjen e kërkesës në gjykatë. Që të lejojë lidhjen e martesës nën moshë, gjykata duhet të vlerësojë të miturin/ën personalisht, pëlqimin e lirë dhe shkakun që për atë të mitur konkretisht paraqet rëndësi. Gjykata nuk bën vlerësime në përgjithësi lidhur me ato që përbëjnë 'shkak me rëndësi' për lidhjen e martesës por i sheh ato në raport me të miturin/ën, pjekurinë e tij/saj fiziko-psikike, pëlqimin e lirë, gadishmërinë për të marrë përsipër përgjegjësitë e martesës, etj. Pra, lidhja e martesës nën moshë investon gjykatën si një autoritet që bën vlerësimin rast pas rasti të shkakut si dhe të kushteve e ndalesave të tjera të parashikuara në KF lidhur me lidhjen e martesës për atë të mitur që ka paraqitur kërkesën.

Prindi/ prindërit si kërkues: sipas KF prindi ka të drejtën e kundërshtimit të martesës. Ndër të tjera, kjo është një arsye më shumë që prindi të mos legjitimohet aktivisht dhe të kërkojë leje për martesën e fëmijës me cilësinë e ushtruesit të përgjegjësisë prindërore.

Bashkëshorti i ardhshëm madhor: bashkëshorti i ardhshëm, edhe nëse ky është madhor, nuk mund t'i drejtohet i vetëm gjykatës për të kërkuar lidhjen e martesës së tij me të miturën. Mosha nuk është pengesë për të por për të miturën. Praktika gjyqësore njeh raste të shtrëngimit ose detyrimit për martesë dhe, që të përjashtohet çdo rrezik si dhe të eliminohet cënimi i të drejtave të miturit/ës, kërkohet që i/e mituri/a, lejimi i martesës të së cilit/ës po çmohet nga Gjykata, të paraqitet personalisht me cilësinë e kërkueses. Në 5 vendime ose 7% nga totali prej 68 kërkesa është bërë nga bashkëshorti i ardhshëm. Në këto vendime nuk del e qartë nëse

e mitura është paraqitur dhe është pyetur ndërkohë që është bërë kujdes që familjarët e djalit dhe vajzës të pyeten dhe të japin pëlqimin e tyre.[17] Dhënia e pëlqimit nga prindi ose kushdo qoftë nuk mund të zëvendësojë në asnjë rast vlerësimin nga gjykata të të miturës. Pra, në vendimet gjyqësore, nevojitet të shprehet qartazi kujdesi për të miturën nëse po e kupton kërkesën që ka paraqitur dhe ndryshimet që sjell në jetën e vet, nëse po e kupton procesin, etj. Është gjithnjë babai që jep pëlqimin, bashkëshorti i ardhshëm, por ajo vet në disa vendime nuk duket protagoniste në martesën e saj.

E mitura si person i tretë: Nuk është korrekte që e mitura të thërritet me cilësinë e personit të tretë kur në fakt procesi fillim e mbarim është për të. Për këtë na vijnë në ndihmë edhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile lidhur me pjesëmarrjen e personave të tretë në procesin civil për të kuptuar se e mitura nuk mund të ketë kurrsesi atë pozicion procedurial.

1.5 Mosha e personit për të cilin/ën kërkohet lidhja e martesës nën moshë

Mosha është një kriter objektiv ligjor. Përcakimi i një kufiri moshe lidhet me daljen nga mituria e cila është grupmosha e dedikuar për zhvillim fizik, psikik, emocional, social etj dhe gjatë të cilës kërkohet përkujdesje e veçantë. Në këtë grupmoshë niveli i përgjegjësive kundrejt të drejtave është në përpjesëtim të zhdrejtë në favor të të drejtave.

Siç vihet re nga të dhënat në vijim numrin më të madh e zë grupmosha mbi 17 vjeç me një diferencë të vogël me grupmosha nën 17 vjeç. Janë 5 vendime ku mosha e të miturës është nën 16 vjeç. Në 3 vendime mosha nuk specifikohet.

[17] Shih Vendimin nr.7/14/01.2015 i GjRrGj Kukës.

Vendimet gjyqësore të periudhës 2011-17 për GjRrGj				
Grupmosha 14 deri në 15 vjeç	Grupmosha 15 deri në 16 vjeç	Grupmosha nga 16 deri në 17 vjeç	Grupmosha mbi 17 vjeç	Pa të dhëna
1 rast	5 raste	26 raste	31 raste	5 raste

Tabelë 3: Grupmosha e të miturës në kërkesat me objekt lejimin e martesës nën moshë

Pra, siç vihet re, në gjykatë paraqiten kërkesa edhe për lidhjen e martesës së të miturave nën moshën 16 vjeç. Ka një rast shqetësues sic është psh rasti i një vendimi të GjRrGj Kukës ku e mitura është 14 vjeç e 2 muaj [vendimi nr. 65/21.12.2016], dhe i është drejtuar gjykatës, por kërkesa është pushuar për shkak të mosparaqitjes së palës kërkuese. Në një vendim të GjRrGj Kavajë e mitura është 15 vjeç e tre muaj [vendimi nr. 84/7.4.2014] dhe në një tjetër të po kësaj gjykate e mitura është 15 vjeç e 10 muaj [Vendimi nr.12-2011-739/1.7.2011]. Vetëm në dy prej tyre, vendimi i GjRrGj Fier nr.1002/15.7.2015, ku e mitura është 15 vjeç e 7 muaj çështja është pushuar dhe në vendimin e GjRrGj Kukës nr.65/21.12.2016, ku e mitura është 14 vjeç e 2 muaj çështja është pushuar.

Është e vërtetë që dispozitat e KF nuk parashikojnë një moshë minimum, nën të cilën nuk mund të lejohet lidhja e martesës as me vendim gjykate, por gjykata ka gjithë diskrecionin, dhe duhet të ushtrojë kujdes maksimal në raste të kërkesave të tilla dhe do të rekomandohej që kërkesa të tilla të gjenin një trajtim të veçantë edhe duke përfshirë autoritete lokale siç parashikohen nga ligji 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me qëllim ndërgjegjësimin dhe parandalimin e martesave në moshë të hershme. Këto autoritete, pra, punojësi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, sipas nenit 51 të ligjit 18/2017, ka për detyrë të identifikojë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjen e fëmijës në rrezik, komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët; të bëjë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje; etj.

Nga analiza e gjithë vendimeve gjyqësore rezulton se mosha e bashkëshortit të ardhshëm varion në kufijtë *19 - 35 vjeç*. Në tabelën më poshtë pasqyrohet diferenca në moshë midis të miturës dhe bashkëshortit të ardhshëm:

Vendimet gjyqësore të periudhës 2011-17 për GjRrGj				
Diferenca në moshë 2-6 vite	Diferenca në moshë 7-10 vite	Diferenca në moshë 11-15 vite	Diferenca në moshë 16-19 vite	Pa të dhëna moshe
12%	32 %	15%	4%	37%

Tabelë 4: Përqindja e rasteve sipas diferencës në moshë midis të miturës dhe bashkëshortit të ardhshëm në kërkesat me objekt lejimin e martesës nën moshë

1.6 Arsimimi i personit për të cilin/ën është bërë kërkesa dhe jepet vendimi për lidhjen e martesës nën moshë

Kjo e dhënë që del nga vendimet e monitoruara sjell këtë bilanc: nga 68 vendime në total:

- ❒ 51 vendime - kjo e dhënë nuk del;
- ❒ 12 vendime - e mitura është me arsim 9 vjeçar
- ❒ 5 vendime - e mitura është me arsim të mesëm

Është e lidhur me interesin më të lartë të fëmijës dhe me të drejtën për arsim marrja e kësaj të dhëne. Kjo do të mundësonte konkluzione lidhur me të drejtën për arsim dhe impaktin e lidhjes së martesës. Gjithashtu do të ishte me interes të mësohej nëse kemi raste të kërkesave për lejim martese nën moshë për të mitur pa asnjë lloj arsim. Martesat në moshë të mitur afektojnë negativisht në realizimin e të drejtave të tjera të kësaj grupmoshe dhe e drejta për arsimim dhe kualifikim është një prej tyre. Do të ishte me interes që nga ana e autoriteteve lokale të monitorohej ecuria në çështjet e arsimimit dhe edukimit të këtyre të miturave dhe efekti i martesës nën moshë në këtë drejtim.

Në paragrafin 30, të Vërejtjeve përmbyllëse të Komitetit CEDAW të vitit 2010 dhe në mënyrë të përsëritur në paragrafin 20 dhe 21 të Vërejtjeve përmbyllëse të Komitetit CEDAW të vitit 2016 për Shqipërinë, shprehet shqetësim i lidhur me numrin e madh të largimeve nga shkolla, veçanërisht në nivelin e mesëm edhe për shkak të martesave të parakohshme, martesat e fëmijëve, zgjedhja e bashkëshortit nga familja dhe pagesa e një çmimi ose prike për nusen, një fenomen ky që është mbizotërues në zonat rurale dhe të largëta dhe në radhët e komuniteteve të vogla. Kjo duhet të tërheqë vëmendjen e gjyqësorit shqiptar për rastet kur kërkohet lidhja e martesës nën moshë e cila ka impakt negativ në arsimimin e vajzave. Në këtë mënyrë, në vendime të tilla, arsimimi i të miturës/it që kërkon të lidhë martesë nën moshë duhet të jetë jo vetëm i pasqyruar në vendimet gjyqësore, por edhe në vëmendje të gjykatës lidhur me realizimin e kësaj të drejte kur lejohet lidhja e martesës nën moshë.

Duke iu referuar rekomandimit të përgjithshëm Nr. 31 të Komitetit CEDAW dhe komentit të përgjithshëm Nr. 18 të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve për praktikat e dëmshme (2014), Komiteti CEDAW gjithashtu rekomandon që vendi ynë të ndalojë të gjitha praktikat e dëmshme, ku përfshihen martesa e fëmijëve, praktika e familjeve që zgjedhin bashkëshortin për vajzën e tyre, etj.

1.7 Vendbanimi i personit të mitur ose kërkuesit jo të mitur në çështjet e lejimit të lidhjes së martesës nën moshë

Sipas vendimeve të marra në analizë lidhur **me vendbanimin e të miturës** për të cilën po kërkohet lidhja e martesës nën moshë, situata është si në vijim:

- ❒ Me vendbanim në qytet - 16
- ❒ Me vendbanim në fshat - 48
- ❒ Me vendbanim jashtë shtetit – 2 [SHBA dhe Kroaci]
- ❒ Me vendbanim që nuk del në vendim - 2

Pra qartësisht del se janë vajzat e mitura me vendbanimin në fshat

ato që kryesisht kërkojnë të lidhin martesë nën moshë

Lidhur **me vendbanimin e bashkëshortit të ardhshëm,** situata është si në vijim:

- ❒ Me vendbanim në qytet - 10
- ❒ Me vendbanim në fshat - 40
- ❒ Me vendbanim jashtë shtetit – 8 [Amerikë, Itali, Maqedoni, Kosovë dhe Kroaci]
- ❒ Me vendbanim që nuk del në vendim - 10

E konsideruam me interes ndikimin e vendbanimit të bashkëshortit të ardhshëm në nxitjen e lidhjes së këtyre martesave. Sepse, në rastet kur përmes martesës kërkohet lëvizja jashtë shtetit, kujdesi i gjykatës për të miturën duhet të jetë edhe më i madh. Konventa e Këshillit të Europës e njohur si Konventa e Stambollit "Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", përkatësisht neni 32 mbi pasojat civile të martesave me detyrime dhe neni 37 mbi martesat me detyrim i kërkon shteteve palë të bëjnë kujdes dhe të marrin gjithë masat për detyrimin për martesë dhe pavlefshmërinë e këtyre martesave.

1.8 Numri i seancave dhe kohëzgjatja e procesit gjyqësor



1 seancë	**45**
2 seanca	**8**
3 seanca	**4**
mbi 3 seanca	**2**
nuk dihet	**9**

Grafik 3: Përqindja e kohëzgjatjes së çështjeve nëpërmjet seancave gjyqësore

66% e shqyrtimeve të kërkesave zgjasin vetëm një seancë. Pra këto hyjnë tek çështjet e shpejta në kohë dhe me numër të pakët seancash gjyqësore.

Gjykimet e kërkesave për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë, përgjithësisht, zhvillohen në pak seanca. Psh, gjykata Tropojë dhe Lezhë të gjitha çështjet i ka shqyrtuar në një seancë ndërsa gjykata e Shkodrës nga 12 kërkesa vetëm një prej tyre ka marrë 2 seanca dhe të gjitha të tjerat vetëm 1 seancë. Gjykata Kavajë nuk e ka mundësuar këtë të dhënë për 7 vendimet e marra.

Përkthyer në kohëzgjatje, përgjithësisht vihet re një vendimmarrje që shkon nga minimumi në 2 ditë siç është rasti i vendimit nr. 1880/31.7.2013 të GjRrGj Shkodër deri në maksimumi në 121 ditë ose 4 muaj si në rastin e vendimit nr. 12-2013-418/3.4.2013 të GjRrGj Kavajë.

Jo në të gjitha rastet, ka një përputhje midis numrit të seancave dhe kohëzgjatjes së proceseve. Çështjet e pushuara ka një kohëzgjatje më të madhe se sa çështjet e pranuara.

2. Pjesëmarrësit në proces

2.1 Zyra e gjendjes civile dhe personi madhor me të cilin po lidhet martesa

Sipas vendimeve të monitoruara të periudhës 2011-17, rezulton se nga 56 vendime të pranuara për lejimin e martesës, *në vetëm 19 prej tyre është thirrur Zyra e Gjendjes Civile* si palë e tretë.

2.2 Roli/pjesëmarrja e psikologut

Nga 68 vendime të periudhës 2011-17 rezulton se në 6 raste *është bërë një vlerësim psikologjik i të miturit/ës dhe në 26 të tjera del qartë se nuk ka patur psikolog të përfshirë në proces*. Në 36 vendime nuk është bërë një vlerësim psikologjik i të miturit/ës.

Për shembull, gjykata Fier nuk ka asnjë të dhënë. Në Kavajë, nga 7 vendime psikologu është përfshirë vetëm në një rast, ndërsa në

vendimet e tjera nuk del e qartë. Tropoja dhe Lezha në asnjë rast nuk e ka përfshirë psikologun. Shkodra vetëm në 3 raste nga 14 çështjet në total ndërsa Kukës vetëm në 2 çështje nga 13 totali.

2.3 Roli i prindërve dhe shoqërimi i të miturit/ës në gjykatë nga të rritur të tjerë

Kush e shoqëron të miturën në proceset e kërkesave të lejimit të lidhjes së martesës nën moshë?

- ❒ Bashkëshorti i ardhshëm - 3
- ❒ Vetëm nëna - 9
- ❒ Vetëm babai - 16
- ❒ Të dy prindërit - 20
- ❒ Asnjë ose nuk del në vendim - 20

Sipas të dhënave të monitoruara ka patur raste që e mitura është shoqëruar edhe nga prindërit e bashkëshortit të ardhshëm, psh në vendimin nr. **7**/14.1.2015 të GjRrGj Kukës.

2.4 Prania e mbrojtësit ligjor/Avokatit

Rezulton se nga 68 vendime, në *28 prej tyre nuk kemi përfaqësimin me avokat* ndërsa në 13 raste ka përfaqësim me avokat. Pjesa tjetër e vendimeve, gjithsej 27 nuk kanë një të dhënë të qartë lidhur me përfaqësimin ose jo me avokat.

Nuk mundet të verifikohet sa në dijeni janë të miturit për të përdorur aksesin në gjykatë përmes ndihmës ligjore falas.

3. Përmbajtja e vendimeve gjyqësore

3.1 Shkaku me rëndësi sipas kërkesës kundrejt shkakut me rëndësi sipas vendimit të gjykatës

Në proceset me objekt lejim lidhje martese nën moshë si shkaqe me rëndësi të pretenduara nga ana e kërkuesve janë:

- ❒ shtatëzania - 40 nga 68 totali **ose 59%.** Nga këto 10 raste vajza e mitur edhe ka bashkëjetuar paraprakisht me djalin.
- ❒ bashkëjetesa - 4 nga 68 **ose 6 %** ku bashkëjetesa del si shkak i vetëm jo e shoqëruar me shtatëzani.
- ❒ nuk ka shkak ose thjesht kërkohet lejim martese - 12 nga 68 **ose 17 %.**
- ❒ martesa zakonore - 3 nga 68 **ose 4 %.**
- ❒ ndërtimi i një jete jashtë shtetit/bashkim familjar - 4 nga 68 **ose 7 %.**
- ❒ lindja e fëmijës - 5 nga 68 **ose 7%.**



Grafik 4: Shkaku me rëndësi sipas kërkesës në Gjykatë

Shtatëzania mbetet shkaku kryesor. Është shqetësuese që në disa vendime nuk ka asnjë shkak konkret por thjesht lejim lidhje martese. Po ashtu është shqetësuese numri i vendimeve, ndonëse i vogël, të cilat bëhet fjalë për martesë sipas të drejtës zakonore.

Në të gjitha çështjet e pranuara, nga arsyetimi del që gjykata ka vlerësuar të njëjtin shkak si shkak me rëndësi në lejimin e martesës nën moshë.

3.2 Vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës në vendimin e gjykatës

Gjykata duhet të arsyetojë se dhënia ose mosdhënia e këtij vendimi është në interesin me të mirë të kërkuesit/es që synon të lidhë martesë nën moshë.

Arsyetimi i vendimit duhet të kalojë në linjën e gjithë analizës mbi shkaqet, motivet, pjekurinë, mendimin e psikologut, etj të cilat u bënë pjesë e shqyrtimit gjyqësor.

Vetëm në 17 vendime gjykatat janë shprehur lidhur me parimin e Interesit më të Lartë të Fëmijës (ILF). Në pjesën tjetër nuk gjendet një analizë e tillë.

Rrethi	ILF vetëm citohet pa u analizuar (raste)	Nuk ka analizë të ILF (raste)	Totali
Shkodër	10	4	14
Kukës	0	13	13
Lezhë	0	5	5
Pukë	0	0	0
Kavajë	0	7	0
Fier	5	13	18
Tropojë	2	9	11
Total (numër)	17	51	68
Total (%)	**25%**	**75%**	**100%**

Tabelë 5: Interesi më i lartë i fëmijës në vendimet gjyqësore

Shkodra – nga 14 totali, në 10 prej tyre analizohet parimi më së shumti thjesht duke e cituar atë dhe pa i hyrë një analize të plotë.

Kukësi – nga totali prej 13, në asnjë vendim nuk gjendet kjo analizë.

Lezha - nga totali prej 5, në asnjë vendim nuk gjendet kjo analizë

Tropoja - nga totali prej 11, në 2 prej vendimeve gjendet kjo analizë jo në thellësinë e mjaftueshme.

Kavaja - nga totali prej 7, në asnjë vendim nuk gjendet kjo analizë.

Fieri - nga totali prej 18, në 5 prej tyre gjendet kjo analizë jo në thellësinë e mjaftueshme.

3.3 Vlerësimi i pjekurisë fiziko-psikike të të miturit dhe kuptimi i qartë i martesës

Pjekuria psikike përfshin qartësinë e kërkuesit/es lidhur me rëndësinë e martesës në tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve që i përkasin. Për gjykatën, pjekuria psikike duhet konstatuar prej veprimeve të subjekteve dhe jo thjesht prej deklarimeve të tyre. Gjykata në këtë vendimmarrje duhet të mbrojë dy institute: miturinë dhe martesën. Duke qenë se nga martesa lindin të drejta, detyrime e përgjegjësi, gjykata duhet të vlerësojë se sa në harmoni është personi me pjekurinë e vet kundrejt këtyre të drejtave dhe detyrimeve që imponon martesa. Gjykata ka mundësi që ta arrijë këtë përmes metodave të ndryshme, përfshi pyetjet e hapura dhe të mbyllura dhe jo ato sugjestionuese. Kuptohet që lista e pyetjeve drejtuar personit mund të jetë e gjatë. Dedikimi në këtë proces është kontribut për mbrojtjen e të miturit dhe të martesës!

Si paraqitet gjendja në vendimet gjyqësore të monitoruara?

Shkodra - nga 14 totali, 8 prej tyre analizohet pjekuria fiziko psikike e fëmijës

Kukësi - nga totali prej 13, në 2 prej tyre gjendet kjo analizë

Lezha - nga totali prej 5, në 2 prej tyre gjendet kjo analizë

Tropoja - nga totali prej 11, në 5 prej tyre gjendet kjo analizë

Kavaja - nga totali prej 7, në asnjë nuk gjendet kjo analizë

Fieri - nga totali prej 18, në 2 prej tyre gjendet kjo analizë

Sa i përket monitorimit të vendimeve rezulton se pjekuria fiziko psikike e fëmijës bëhet në mënyrë sipërfaqësore, pa analizuar në mënyrë të mirëfilltë kontekstin zhvillimor fizik dhe mendor në përputhje me moshën dhe mënyrën e rritjes.

3.4 Vlerësimi nga ana e të miturit/ës për të kuptuar qartë martesën dhe gadishmëria e të miturit për të marrë përgjegjësi

Nga analiza e këtij aspekti në vendimet gjyqësore rezulton se:

- Shkodra - nga 14 totali, 10 prej tyre analizohet ky aspekt
- Kukësi - nga totali prej 13, në asnjë nuk gjendet kjo analizë
- Lezha - nga totali prej 5, në asnjë nuk gjendet kjo analizë
- Tropoja - nga totali prej 11, në 2 prej tyre gjendet kjo analizë
- Kavaja - nga totali prej 7, në asnjë nuk gjendet kjo analizë
- Fieri - nga totali prej 18, në 5 prej tyre gjendet kjo analizë

Gjykatës i duhet të vlerësoj nëse kërkuesi/a i/e mitur e ka të qartë konceptimin e martesës si një akt personal përmes së cilit ai/ ajo dhe bashkëshorti/a i/e ardhshëm synojnë të krijojnë një bashkësi materiale dhe shpirtërore për tërë jetën e tyre.

II - Analiza sociale e rasteve të martesave nën moshë

1. *Analizë e gjetjeve me aspekt shoqëror në lidhje me martesat nën moshën e lejuar në Shkodër, Kukës, Lezhë, Tropojë, Pukë, Fier dhe Kavajë*

1.1 Karakteristikat demografike sipas hulumtimit në Shkodër, Kukës, Tropojë, Lezhë, Pukë, Fier dhe Kavajë

Nga 68 rastet që i janë drejtuar Gjykatës me objekt 'lejim lidhje të martesës nën moshë' janë identifikuar dhe intervistuar 34 prej tyre. Në Shkodër, nga 14 raste janë intervistuar 12 prej tyre, ndërsa 2 raste të tjera nuk janë gjetur. Në Kukës janë intervistuar 4 gra nga martesa nën moshë, ndërsa për 9 raste nuk është arritur vendosja e komunikimit; Në Kavajë janë intervistuar 6 gra, ndërsa 1 grua nuk është inervistuar pasi jetonte jashte. Në Fier numri i të anketuarve ishte 12, ndërsa 4 persona nuk janë gjetur dhe 2 janë larguar jashtë vendit. Në Tropojë asnjë nga të 11 rastet nuk është arritur të gjendet. Në Pukë nuk paraqitet asnjë rast legjimimi të martesës nën 18 vjeç. Në Lezhë nga 5 rastet, 3 individë nuk janë gjetur dhe 2 kanë refuzuar të intervistohen.

Të gjitha gratë që janë intervistuar kanë deklaruar se janë martuar para moshës tetëmbëdhjetë vjeçare, edhe pse, 4 raste në Fier janë çështje të pushuara, ku gjykata nuk e ka legjitimuar martesën nën moshë.

1.1.1 Mosha aktuale e të intervistuarve

Grupmosha *aktuale* dominuese e grave të martuara nën moshë është mes moshës *19 dhe 25 vjeç*, duke përfaqësuar mbi 85% të kampionimit në të gjitha qytetet.



Grafik 5: Mosha aktuale e të intervistuarve sipas anketimit

1.1.2 Mosha kur janë martuar të anketuarat

Pothuajse të gjitha të anketuarat janë martuar gjatë moshës 16- 17 vjeç. *Paraqitet vetëm një rast në Kavajë ku martesa ka ndodhur në moshën 14 vjeç.*

Vlejnë për tu theksuar edhe 4 raste në Fier ku çështja është pushuar. Në njërin (1) rast vajza ka mbushur 18 vjeç gjatë gjykimit dhe nuk ka qënë nevoja që martesa të kalojë përmes gjykatës. Në dy (2) nga rastet, palët nuk janë paraqitur në gjykatë, por gjithsesi këto vazja raportojnë një moshë martese nën 18 vjeç (15 vjeç njëra vajzë dhe 12 vjeç vajza tjetër). Në njërin (1) rast çështja është pushuar pasi gjykata nuk ka gjetur shkaqe me rëndësi për të lidhur martesën, por gjithsesi vazja raporton si moshë martese moshën 15 vjeç.

Mosha kur jeni martuar:	Shkodër	Kukës	Kavajë	Fier
14 vjeç	0	0	1	0
15 vjeç	0	0	0	0
16 vjeç	4	2	2	2
17 vjeç	8	2	3	6

Tabelë 6: Mosha e martesës së të intervistuarave sipas anketimit

1.1.3 Mosha kur kanë sjellë në jetë fëmijën e parë

Shumica e grave të martuara nën moshë janë tashmë nëna, përkatësisht 74% e tyre. Në kampionin e Shkodrës, në 67% të rasteve, fëmija i parë ka ardhur në jetë kur nëna i përkiste grupmoshës 17 – 18 vjeç, ndërsa pjesa tjetër e rasteve pas moshës 18 vjeç. Në Kukës, në 50% të rasteve, fëmija ka ardhur në jetë kur nëna i përkiste grupmoshës 15-16 vjeç, ndërsa në pjesën tjetër kur nëna i prkiste grupmoshës 17-18 vjeç. Në Kavajë, në 20% të rasteve, lindja e fëmijës ka ndodhur kur nëna i përkiste grupmoshës 15-16 vjeç, 40% e rasteve në grupmoshën 17-18 vjeç, ndërsa në pjesën tjetër prej 40%, kur nëna ishte mbi 18 vjeç. Përsa i përket Fierit, rastet mbizotëruese janë ato kur fëmija ka ardhur në jetë kur nëna i përkiste grupmoshës 15-16 vjeç dhe 17-18 vjeç, përkatësisht 36% e rasteve për secilën grupmoshë. *Me shqetësim paraqitet një (1) rast në Fier kur nëna pranon se fëmija i parë ka lindur kur ajo ishte 13 vjeç.*

Në të gjitha rastet në Shkodër dhe Kavajë raportohet se martesa ka ndodhur para lindjes së fëmijës, ndërsa në Kukës situata paraqitet e kundërt, ku në të gjitha rastet martesa ka ndodhur pas lindjes së fëmijës. Ndërkohë në *Fier*, në *64%* të rasteve, martesa ka ndodhur pas lindjes së fëmijës.



Grafik 6: Mosha e nënës kur ka lindur fëmijën e parë sipas anketimit

1.1.4 Statusi aktual i të martuarave nën moshë

Situata përsa i përket gjendjes së martesës paraqitet solide në të gjitha rastet në Shkodër, Kukës dhe Fier. Në Kavajë paraqitet një rast i vetëm në proces divorci.

Statusi aktual ligjor:	**Shkodër**	**Kukës**	**Kavajë**	**Fier**
E martuar	100%	100%	83%	100%
E divoruar	0%	0%	0%	0%
E ve	0%	0%	0%	0%
Beqare	0%	0%	0%	0%
Në proces divorci	0%	0%	13%	0%

Tabelë 7: Statusi i martesës sipas anketimit

1.1.5 Diferenca në moshë midis bashkëshortëve

Në Shkodër diferenca e moshës bashkëshortore varion nga *2 deri në 16 vjet* dhe dominon diferenca në moshë nga *6 deri në 10 vjet* dhe *11 deri në 15 vjet* me *36%* të rasteve secila kategori. *Në Kukës, Kavajë dhe Fier* diferenca në moshë e çiftit është më e ulët dhe varion nga *2 në 10 vjet*. Në *Kukës 50%* e të anketuarve paraqesin një diferencë moshe me bashkëshortin nga *1 deri në 5 vjet. Në Kavajë dhe Fier* dominuese është diferenca *5-10 vjet* me përkatësisht *75%* dhe *80%* të rasteve.

1.1.6 Mosha e prindërve të të intervistuarve

Prindërit e grave të intervistuara raportohet të jenëmes moshës *35 dhe 70 vjeç*. Pjesa më e madhe e prindërve femra i përkasin grupmoshës *41-50 vjeç (55% e rasteve),* ndërsa pjesa më e madhe e prindërve meshkuj i përkasin grupmoshës *51-60 vjeç (58% e rasteve).*

Mosha e prindërve (vjeç)	Shkodër	Kukës	Kavajë	Fier
Mosha e nënës:				
35-40 vjeç	0	0	0	3
41-50 vjeç	8	2	4	4
51-60 vjeç	3	2	2	5
61-70 vjeç	0	0	0	0
Mosha e babait				
35-40 vjeç	0	0	0	0
41-50 vjeç	3	2	0	5
51-60 vjeç	6	2	6	5
61-70 vjeç	2	0	0	2

Tabelë 8: Mosha e prindërve të vajzave në martesë nën moshë sipas anketimit

1.1.7 Lloji i familjeve

Pjesa më e madhe e të intervistuarave janë vajza të rritura në familje me të dy prindërit, përkatësisht *75%* e të intervistuarave në *Shkodër, 83%* në *Kavajë* dhe *100%* e të intervistuarave në *Kukës* dhe *Fier.*

	Shkodër	Kukës	Kavajë	Fier
Lloji i familjes:				
Me të dy prindërit	9	4	5	12
Me njërin prind	2	0	1	0
Me prindër të ndarë	1	0	0	0
Me prindër të rimartuar	0	0	0	0
Gjendja ligjore e prindërve				
Beqare	0		0	0
Martuar	8		5	12
Divorcuar	1		1	0
E ve	3		0	0

Tabelë 9: Lloji dhe statusi i familjeve ku janë rritur të anketuarat

1.1.8 Statusi i punësimit të prindërve

Shumica e prindërve e të intervistuarave janë të papunë, me *100% të rasteve në Kukës, 33% e rasteve në Kavajë* dhe *67% e rasteve në Fier*. Papunësia është një faktor shqetësues i cili reflektohet edhe në statusin e punësimit të grave të martuara nën moshë.

A janë të punësuar prindërit tuaj:	Shkodër	Kukës	Kavajë	Fier
Po		0	4	4
Jo		4	2	8

Tabelë 10: Statusi i punësimit të prindërve të të miturave

1.1.9 Migrimi i prindërve

Migrimi i prindërve nuk duket të korrelohet si faktor i rëndësishëm në lidhje me martesat nën moshë, ku *100%* e prindërve në *Kukës*, *50%* e prindërve në *Kavajë* dhe *25%* e rasteve në *Fier* nuk kanë qënë kurrë në emigrim.

1.2 Karakteristikat e historikut arsimor të grave të martuara nën moshë

1.2.1 Niveli i Arsimimit

Gratë me nivel të ulët arsimor dominojnë grupin e të anketuarve në të gjitha zonat, përkatësisht *100%* të rasteve në *Kukës, 83% e rasteve në Kavajë* dhe *67% të rasteve në Fier*. Nga të dhënat ndërkombëtare evidentohet një korrelacion midis nivelit të ulët të arsimimit dhe martesave nën moshë. Nga krahasimi i nivelit arsimor të prindërve me atë të intervistuarave evidentohet një rritje shumë e vogël e numrit të viteve të kaluara në arsim të të intervistuarve në krahasim me prindërit. Përputhja e nivelit të edukimit të të intervistuarave me atë të prindërve të tyre mund të jetë domethënës e shpjegues për shkakësinë e martesës para moshës së lejuar.



Niveli i arsimimit të prindërve:	Kavajë	Fier
Pa arsim	0	1
Fillor	0	0
8 vjeçar	4	7
I mesëm	2	4
I lartë	0	0

Grafik 7: Niveli i arsimimit të anketuarave

Tabelë 11: Arsimi prindëror

1.2.2 Arritjet dhe rezultatet në shkollë

Shumica e të intervistuarave tregojnë për rezultate shumë të mira ose mesatare në shkollë. *Në Kukës, 100%* e të anketuarave paraqiten me rezultate *mesatare* në shkollë. Në Kavajë numri i atyre me rezultate shkollore të *mira* dhe *mesatare* shkon në *40%*, ndërsa *në Fier 80%* e të anketuarave paraqiten me rezultate *shumë të mira* në shkollë. Po ashtu pjesa më e madhe e të anketuarave nuk i janë kthyer shkollës pasi kanë sjellë në jetë fëmijën e tyre të parë, siç tregon edhe grafiku në vijim.



Grafik 8: Shkollimi pas lindjes së fëmijës

1.2.3 Prirjet profesionale

Shumica e grave në këtë lloj situate sipas hulumtimit të kryer nuk punojnë jashtë shtëpisë, përkatësisht *75%* e grave në Fier. Në qytetet e tjera, të intervistuarat nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje. *100%* e grave në *Kukës, 75%* e rasteve në *Kavajë* dhe *Fier* shprehen se nuk kanë qëllime për karrierë profesionale.

1.3 Jeta familjare dhe statusi shoqëror i grave të martuara nën moshë

1.3.1 Bashkëjetesa me prindërit e bashkëshortit

Ndërkohë familjet që kanë origjinën nga martesa nën moshë bashkëjetojnë me prindërit e bashkëshortit në *67%* të rasteve të intervistuara. Po ashtu duket se familjet e krijuara nga martesa nën moshë, bashkëjetojnë me familjen e bashkëshortit për një periudhë deri në të paktën dy vjet pas lindjes së fëmijës së parë. Nga analizimi i rasteve të këtij studimi, rezulton se *pas vitit të pestë të martesës,* familjet e krijuara nga martesat nën moshë, jetojnë më vete ekonomikisht. Këto të dhëna kërkojnë studime më të thelluara nga institucionet për të kuptuar më mirë dinamikën e familjes së "madhe" shqiptare gjatë dekadës së fundit.

Nr viteve që keni jetuar me familjen e bashkëshortit përpara se të lindnit fëmijën:	**Shkodër**	**Kukës**	**Kavajë**	**Fier**
0-1 vite	7	1	1	4
2-5 vite	0	0	4	5
5+ vite	0	0	1	2

Tabelë 12: Vitet e jetesës me familjen e bashkëshortit

1.3.2 Numri i fëmijëve

Në të gjitha zonat predominojnë familjet me *një (1)* ose *dy (2) fëmijë.* Kjo prirje tregon se edhe në këto lloj familjesh shkohet drejt konceptit të familjes bërthamë.

Sa fëmijë të tjerë keni lindur pas fëmijës së parë?	Shkodër	Kukës	Kavajë	Fier
0	3		4	3
1	1		2	6
2	2		0	2

Tabelë 13: Numri i fëmijëve të lindur pas fëmijës së parë

1.3.3 Gjendja shëndetësore e fëmijëve

Sipas deklarimit të të intervistuarave, gjendja shëndetësore e fëmijëve paraqitet *shumë e mirë ose e mirë* pothuajse në të gjitha rastet. Mund të veçojmë vetëm një (1) rast fëmije në Fier, gjendja shëndetësore e të cilit paraqitet keq.

Si është gjendja shëndetësore e fëmijës/ëve?	Shkodër	Kukës	Kavajë	Fier
Shumë e mirë	6	4	4	2
E mirë	0	0	1	8
Keq	0	0	0	1
Shumë keq	0	0	0	0

Tabelë 14: Gjendja shëndetësore e fëmijëve sipas vlerësimit mëmësor

1.3.4 Statusi familjar i të intervistuarave pas lindjes së fëmijës së parë

Përmes këtij raporti jemi përpjekur të hedhim dritë edhe mbi qëndrimin kundrejt lindjes së fëmijëve të seksit femër dhe lidhjes së numrit të dështimeve me gjininë. Situata duket problematike vetëm në Kukës, ku njëra nga të intervistuarat shprehet se ka patur probleme për shkak se ka lindur vajzë, ndërkohe që 3 të intervistuarat e tjera nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje. Gjithashtu alarmante situata në këtë zonë duket edhe përsa i përket numrit të aborteve, ku të 4 të intervistuarat shprehen se janë detyruar të kryejnë abort të fëmijës.

Nëse keni lindur vajzë, a ka pasur probleme?	Shkodër	Kukës	Kavajë	Fier
Po	0	1	0	0
Jo	6	0	1	11
A jeni detyruar të kryeni abort (dështim) të fëmijës?				
Po	0	4	0	0
Jo	6	0	5	11

Tabelë 15: Problematika gjinore

1.3.5 Rritja e fëmijës

Në të gjitha rastet janë të afërmit dhe familjarët që ndihmojnë nënat e martuara nën moshë në procesin e rritjes së fëmijës. Në asnjë rast nuk raportohet frekuentimi i çerdheve nga fëmijët e këtyre familjeve, kjo pasi shumica e grave të martuarave nën moshë nuk punojnë jashtë shtëpisë.

1.4 Arsyet e martesave nën moshë dhe lidhjes ligjore

Shumica e të intervistuarve janë përgjigjur se arsyeja kryesore e martesës nën moshë lidhet me *rënien në dashuri* në 44% të rasteve ose 14 raste. *Katër (4)* prej të intervistuarave përmendin si shkak të martesës nën moshë *migrimin* (për të patur mundësi të emigrojnë jashtë shtetetin ku i fejuari jeton). Gjithashtu vemë re se disa prej tyre përmendin *varfërinë dhe gjendjen e vështirë ekonomik* si shkaqe dytësore. *Mentaliteti dhe zakonet kulturore* gjithashtu duket të luajnë një rol në vendimin për t›u martuar shumë herët. *Vlen për tu theksuar një rast në Kavajë , e cila si shkak të martesës përmend përdhunimin.*



Grafik 9: Shkaqet e martesës nën moshë

Gratë e martuara nën moshë ishin shpesh si të përhumbura për pyetjet në lidhje me statusin e tyre ligjor dhe të drejtat e tyre pas emancipimit ligjor për shkak të martesës. Edhe pse nuk ishte ushtruar dhunë apo detyrim në procesin e martesës në gjykatë, një pjesë e grave në procesin e intervistimit kanë treguar intensitet të lartë emocional dhe kanë përmendur edhe përdorimin e dhunës në një rast.

I intervistuari a ka treguar shenja të shqetësimit emocional?	**Kukës**	**Kavajë**	**Fier**
Po	0	2	0
Jo	4	3	12
A është dëmtuar fizikisht ose sulmuar?			
Po	0	1	0
Jo	4	4	12

Tabelë 16: Gjendja emocionale gjatë intervistimit

1.5 Shkaku me rëndësi i vendimit të gjykatës

Të dhënat e martesave nën moshë në këtë raport tregojnë se ky fenomen është një nënrrymë me kah të kundërt që po bëhet më i fortë, dhe si i tillë meriton vëmendjen e shoqërisë dhe politikëbërësve. Shtatzënia është parë si një justifikim për të lejuar martesën nën moshë. Për t'u theksuar janë edhe *tre (3) rastet në Shkodër* ku të intervistuarat shprehen se gjykata ka legjitimuar martesën për bërjen e dokumentave për bashkim familjar, ndërkohë që bashkëshorti jetonte jashtë, si dhe dy (2) raste në Kavajë ku lidhja e martesës është bërë për shkak se tashmë ka ndodhur lidhja e martesës sipas traditës.



Grafik 10: Shkaku për lejimin e martesës nga Gjykata

III. Shqetësimet kryesore për martesat nën moshë

Edhe në këtë studim vazhdojnë të jenë prezente një pjesë e mirë e shqetësimeve të identifikuara më parë:

1. Martesat nën moshë në Shqipëri vazhdojnë të konsiderohen një praktikë tradicionale dhe si të tilla vazhdojnë të jenë të pranishme në vend. Vendimet në shumicën e tyre flasin për 'martesë' jashtë gjykatës dhe që ka paraprirë vendimin dhe për institutin jo juridik të 'fejesës'.

2. Vajzat e reja ndikohen që të besojnë se siguria ekonomike dhe premtimi për një "jetë të rehatshme" që po i ofrohet janë faktorët kryesorë që do t'i sigurojnë një jetë të lumtur, kjo sidomos në rastet kur dhëndrri është emigrant. Ato nuk detyrohen të martohen me burra të panjohur, por mbetet e paqartë nëse martesa ka ndodhur me pëlqimin dhe bindjen e plotë dhe të pandikuar tëpalëve të përfshira për t'u martuar, për tu martuar nga presioni familjar, apo nga situata socio-ekonomike në familjen e origjinës.

3. Tranzicioni drejt një shoqërie më të hapur nuk është shoqëruar me shpërndarjen e informacionin në masën e duhur, veçanërisht për sa i përket planifikimit familjar dhe edukimit seksual. Martesa konsiderohet si një zgjidhje e artë edhe para presionit për vajzat për të dhënë pëlqimin për martesë apo bashkëjetesë menjëherë sapo shtatzënia/ marrëdhënia bëhet publike. Në një rast të tillë, ka një tendencë për ta konsideruar martesën nën moshë automatikisht si zgjidhjen e vetme dhe më të mirë si për të miturën ashtu dhe për foshnjen që pritet të vij në jetë.

4. Gratë e martuara nën moshë nuk kthehen në shkollë dhe shumica e tyre nuk kanë menduar për të patur një jetë profesionale sidomos pas lindjes, duke u përkushtuar vetëm në familje dhe në ambjentet e shtëpisë.

5. Vetë komuniteti e pranon këtë fenomen dhe shkollat dhe institucionet e tjera sociale nuk duken të përgatitura për të

adresuar çështjen e martesave nën moshë: si parandalimin e tyre ashtu edhe procesin e riintegrimit të grave të martuara nën moshë.

6. Ndërgjegjësimi dhe trajnimi mbi dukurinë e martesës nën moshë nuk është realizuar në masën e duhur nga shoqëria civile dhe organizatat e grave. Ky ndërgjegjësim duhet të realizohet nëpërmjet bashkëpunimit me pushtetin vendor.

7. Mungon ndjeshmëria dhe vetëdija kritike nga ana e medias në trajtimin e çështjeve që lidhen me seksualitetin e fëmijëve dhe me martesat nën moshë. Nevoja për trajnimin dhe ndërgjegjësimin e tyre në raportimin e këtyre çështjeve është e domosdoshme.

8. Martesat nën moshë për qëllime emigrimi konsiderohen si një hap i rëndësishëm në fillimin e një jete të lumtur dhe të rehatshme për të miturën, por ndodh shpesh që ato të bëhen dramatike dhe kthehen në abuzime dhe shfrytëzim seksual.

IV. Përmbledhje e rekomandimeve kryesore. Udhëzues për gjykatën në shqyrtimin e kërkesave me objekt 'lejimin e lidhjes së martesës nën moshë'[18]

Në vijim po rendisim disa nga rekomandimet që çmojmë të jenë në vëmendje të gjykatës në rastin e lejimit të lidhjes së martesës nën moshë.

- ❒ Për gjykatën, mbajtja në vëmendje e interesit të të miturit, duhet të jetë konsiderata kryesore dhe ky kujdes i veçantë nevojitet të pasqyrohet në mënyrë sa më të qartë përmes analizës konkrete sipas rastit, në përmbajtjen e vendimit.

- ❒ Vetëm i mituri që kërkon të lidhë martesë nën moshë është ai që legjitimohet aktivisht në bërjen e kërkesës.

- ❒ Prindi, sipas KF, ka të drejtën e kundërshtimit të martesës. Në këto kushte nuk mund të jetë ai që vepron në emër të të miturit dhe nuk mund të kërkojë leje për martesën e fëmijës me cilësinë e ushtruesit të përgjegjësisë prindërore.

- ❒ Legjislacioni shqiptar nuk e njeh pranimin ose pëlqimin e prindërve si detyrim për lidhjen e martesës nën moshë. Duke qenë se prindërit kanë të drejtën e kundërshtimit të martesës, vlerësimi i mendimit të tyre nga ana e gjykatës duhet bërë kundrejt interesit të të miturit dhe për të parë sa ndikim kanë prindërit në cënimin e vullnetit të lirë.

- ❒ Bashkëshorti i ardhshëm nuk mund të legjitimohet aktivisht, në lejimin e lidhjes së martesës në moshë. Ky është subjekt që nevojitet domosdoshmërisht të thërritet në proces me cilësinë e personit të tretë.

---

[18] Një pjesë e rekomandimeve janë marrë nga botimi i autores Arta Mandro Balili "Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore. Roli i gjyqësorit shqiptar në eliminimin e tij'. Botim i SHM dhe UNDP. Tiranë, Prill 2014. Fq 46-78.

- Parim shumë i rëndësishëm që duhet të mbahet nën kontroll nga ana e gjykatës është autonomia e vullnetit të të miturit/ës që kërkon leje për lidhjen e martesës nën moshë. Për të vlerësuar këtë vullnet, i mituri duhet të jetë prezent personalisht gjatë gjithë procesit. Gjykata duhet të garantojë të drejtën e të miturit për t'u dëgjuar dhe informuar, gjykata të mbajë në vëmendje se sa më e vogël mosha aq më lehtë manipulimi i të miturit në lidhjen e martesës pa pëlqimin e lirë.

- Gjykata që investohet për lejimin e martesës nën moshë, e jep vendimin pas një analize tërësore të shkaqeve me rëndësi të pretenduara; arsimi jashtë shtetit mund të sigurohet edhe pa lidhur detyrimisht martesën me një person që jeton jashtë shtetit; raste të tilla duhet të monitorohen me kujdes sepse mund të jenë burim shfrytëzimi, trafikimi, punë e detyruar, etj

- Nëse gjykata e çmon, i mituri mund të pyetet veçmas. Gjykata është e inkurajuar të marrë mendimin e të miturit në kushte ku nuk ka asnjë ndikim ndaj tij/saj. Pra i mituri nevojitet të merret në pyetje jo në prani të prindërve, kujdestarit ose bashkëshortit të ardhshëm dhe të të rriturve të tjerë; një listë pyetjesh e gatshme mund të lehtësojë gjykatën në komunikimin me të miturin për të kuptuar lirinë e vullnetit dhe aspekte të tjera.

- Gjykata nevojitet të verifikojë dhe pasqyrojë në vendim pjekurinë fiziko-psikike të personit nën moshën 18 vjeç që bën kërkesë për lidhje martese nën moshë. Për këtë ajo mund të përpilojë një listë me pyetje edhe të thjeshta për të parë reagimin e të miturit. Pjekuria psikike përfshin qartësinë e kërkuesit/es lidhur me rëndësinë e martesës në tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve. Pjekuria psikike duhet konstatuar prej veprimeve të subjekteve dhe jo thjesht prej deklarimeve të tyre. Gjykata në këtë vendimmarrje duhet të mbrojë të miturit dhe martesën. Duke qenë se nga martesa lindin të drejta, detyrime e

përgjegjësi, gjykata duhet të vlerësojë se sa në harmoni është personi me pjekurinë e vet kundrejt këtyre të drejtave dhe detyrimeve që imponon martesa dhe të informojë të miturin.

- Gjykata nevojitet të verifikojë rëndësinë e motivit/shkakut të pretenduar dhe që shoqëron kërkesën për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë. Motivi duhet trajtuar në raport me atë se çfarë i shtyn subjektet të kërkojnë lejen e gjykatës për lidhjen e martesës përpara kohe dhe jo sipas rregullave të martesës. Duhet të ketë arsye të mira për të lidhur këtë martesë. A po lidhet martesa nga turpi? Presioni? Nevoja ekonomike? Detyrimi? Etj.

- Gjykata nevojitet të verifikojë bazueshmërinë e motivit. Është ky një motiv fiktiv apo real? Kjo realizohet përmes pyetjeve. Nëse është real sa i bazuar është për të bërë një kërkesë në shkelje të rregullit të përgjithshëm të moshës? Arsyet duhet të jepen qartë. Ato duhet të jenë konkrete e reale. Pas shkaqeve që justifikohen si të rëndësishme mund të qëndrojnë të tjera që mund të sjellin rrezik për të miturin/ën.

- Marrja e mendimit të psikologut lidhur me anën psikologjike, pëlqimin e lirë dhe situatën sociale është një detyrim ligjor dhe ndihmesë e madhe për gjykatën që të japë një vendim të drejtë dhe të gjykojë mbi rëndësinë e shkaqeve dhe bazueshmërinë e tyre si dhe pjekurinë fiziko-psikike duke e bërë këtë verifikim edhe përmes psikologut. Gjykata edhe në gjykime të tilla duhet të respektojë parimin e nenit 6 të Kodit të Familjes dhe të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) sipas të cilit: "Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme për të vlerësuar thëniet e të miturit, në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën sociale". Një rol të veçantë ndihmës për gjykatën në vendimarrje të tilla mund të luajnë Njësitë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në nivel vendor si edhe punojësit social.

- ❒ Reduktimi drejt eliminimit të martesave nën 16 vjeç duhet të jetë në vëmendje të gjykatës dhe të bëhet praktikë e saj. Pra, në asnjë rast, të mos lejohet lidhja e martesës nën këtë moshë pavarësisht justifikimeve.

- ❒ Gjykata nevojitet të mbajë në vëmendje se të miturat me gjendje të vështirë ekonomike janë më të ekspozuara ndaj rrezikut të martesave fiktive apo premtimeve për martesë që përfundojnë në shfrytëzim për prostitucion, trafikim ose çdo lloj forme tjetër shfrytëzimi.

- ❒ Në këndvështrimin e legjislacionit, ende ka vend për përmirësime përsa i përket legjitimimit aktiv të të miturës dhe përcaktimit të një moshe minimum nën të cilën nuk mund të lejohet për asnjë arsye martesa nën moshë. Gjithashtu, shumë nga sugjerimet e përfshira në këtë dokument, mund të shoqërohen edhe me përmirësime ligjore. Mbetet ende me rëndësi përqasja me standardet ndërkombëtare të cituara në raport.

Problemet dhe çështjet që shoqërojnë martesat nën moshë, kërkojnë një analizë të thelluar të kësaj situate në të gjithë vendin.

Një ndërhyrje adekuate dhe produktive në këtë drejtim lidhet me bashkimin e ndërhyrjeve dhe përpjekjet për të përmirësuar gjëndjen e grave të martuara nën moshë, duke sjellë sëbashku politikë-bërësit, strukturat shtetërore në zbatimin e ligjeve që lidhen me martesën, organizatat e shoqërisë civile, donatorët, shkollat dhe komunitetin në të cilin ato jetojnë.

Le t'u japim këtyre vajzave një zë dhe t'i lëmë ato të kenë një fëmijëri të shëndetshme dhe me dinjitet!

V. Bibliografia

Konventa CEDAW "Për eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas"

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve

Konventa e Këshillit të Europës e njohur si Konventa e Stambollit "Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"

Prof. Dr. Arta Mandro Balili (Prill 2017) "Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore. Roli i gjyqësorit shqiptar në eliminimin e tij", Botim i Shkollës së Magjistraturës dhe UNDP, Fq 46-78.

Raporti Vlerësues i GREVIO-s mbi masat legjislative dhe masa të tjera që i japin efekt dispozitave të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) Shqipëri. GREVIO/Inf (2017) 13, Botuar më 24 Nëntor 2017.

Arta Mandro-Balili, Bernard Zeneli (2017), Martesë në Gjykatë? – Të drejtat e fëmijëve, martesa nën moshë dhe roli i gjykatës, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, Tiranë, http://observator.org.al/wp-content/uploads/2017/03/Raporti-martesat-nen-moshe_al.pdf

Cedaw/CALB/CO/4, 25 July 2016. Shih për më shumë: Komiteti vlerësoi raportin e katërt periodik të Shqipërisë (CEDAW/C/ALB/4) në seancën e 1413-të dhe 1414-të, më 12 korrik 2016 (shih CEDAW/C/SR.1413 dhe 1414). Lista e Komitetit me çështjet dhe pyetjet e ngritura janë përfshirë në CEDAW/C/ALB/Q/4 dhe përgjigjet e Shqipërisë janë përfshirë në CEDAW/C/ALB/Q/4/Add.1.

SHTOJCA A: Vendimet gjyqësore

Vendimi nr **171**/02.02.2015 i GjRrGj Shkodër
Vendimi nr **1313**/16.10.2014 i GjRrGj Shkodër
Vendimi nr **1882**/31.7.2013 i GjRrGj Shkodër
Vendimi nr **1880**/31.7.2013 i GjRrGj Shkodër
Vendimi nr **2144**/10.10.2013 i GjRrGj Shkodër
Vendimi nr **292**/6.2.2013 i GjRrGj Shkodër
Vendimi nr **168**/24.1.2013 i GjRrGj Shkodër
Vendimi nr **1068**/29.4.2013 i GjRrGj Shkodër
Vendimi nr **1727**/27.6.2012 i GjRrGj Shkodër
Vendimi nr **2878**/22.11.2012 i GjRrGj Shkodër
Vendimi nr **795**/23.3.2012 i GjRrGj Shkodër
Vendimi nr **1169**/3.5.2012 i GjRrGj Shkodër
Vendimi nr **51-2011-797**/10.3.2011 i GjRrGj Shkodër
Vendimi nr **51-2011-2056**/23.5.2011 i GjRrGj Shkodër
Vendimi nr **7**/14.1.2015 i GjRrGj Kukës
Vendimi nr **27**/19.5.2015 i GjRrGj Kukës
Vendimi nr **43**/10.7.2015 i GjRrGj Kukës
Vendimi nr **20**/4.4.2017 i GjRrGj Kukës
Vendimi nr **54**/17.10.2017 i GjRrGj Kukës
Vendimi nr **63**/11/12/2017 i GjRrGj Kukës
Vendimi nr **35**/19.2.2014 i GjRrGj Kukës
Vendimi nr **299**/30.7.2012 i GjRrGj Kukës
Vendimi nr **138**/30.7.2014 i GjRrGj Kukës
Vendimi nr **142**/9/9/2014 i GjRrGj Kukës
Vendimi nr **439**/1/12/2011 i GjRrGj Kukës
Vendimi nr **46**/11.12.2013 i GjRrGj Kukës
Vendimi nr **65**/21/12/2016 i GjRrGj Kukës
Vendimi nr **81**/31.01.2011 i GjRrGj Lezhë
Vendimi nr **235**/11.3.2011 i GjRrGj Lezhë
Vendimi nr 15.12.2011 i GjRrGj Lezhë (nuk është shënuar nr. vendimit, por nr regjistrimit është 1140)
Vendimi nr **26**/13.01.2014 i GjRrGj Lezhë
Vendimi nr **494**/26.09.2014 i GjRrGj Lezhë
Vendimi nr **90**/29.4.2011 i GjRrGj Tropojë
Vendimi nr **135**/14.6.2011 i GjRrGj Tropojë
Vendimi nr **206**/30.9.2011 i GjRrGj Tropojë
Vendimi nr **39**/10.2.2012 i GjRrGj Tropojë
Vendimi nr **118**/7.6.2012 i GjRrGj Tropojë
Vendimi nr **64**/25.4.2013 i GjRrGj Tropojë
Vendimi nr **54**/ 2.2.2015 i GjRrGj Tropojë
Vendimi nr **234**/3.10.2016 i GjRrGj Tropojë
Vendimi nr **235**/4.10.2016 i GjRrGj Tropojë
Vendimi nr **321**/21.12.2016 i GjRrGj Tropojë
Vendimi nr **75**/24.4.2017 i GjRrGj Tropojë
Vendimi nr **12-2011-1136**/17.10.2011 i GjRrGj Kavajë
Vendimi nr **12-2011-739**/1.7.2011 i GjRrGj Kavajë
Vendimi nr **12-2011-1009**/26.9.2011 i GjRrGj Kavajë
Vendimi nr **12-2012-1297**/30.4.2012 i GjRrGj Kavajë
Vendimi nr **12-2013-418**/3.4.2013 i GjRrGj Kavajë
Vendimi nr **84**/7.4.2014 i GjRrGj Kavajë
Vendimi nr **12-2016-947**/13.6.2016 i GjRrGj Kavajë
Vendimi nr **3032**/27.6.2017 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **1769**/19.12.2017 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **299**/22.2.2011 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **602**/5.5.2017 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **1542**/3.10.2013 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **595**/4.5.2017 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **208**/7.2.2011 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **302**/22.2.2011 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **963**/14.5.2012 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **414**/1.4.2014 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **498**/21.3.2013 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **1591**/14.10.2013 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **248**/15.2.2011 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **1366**/28.6.2012 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **360**/3.3.2011 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **1002**/15.7.2015 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **992**/14.7.2015 i GjRrGj Fier
Vendimi nr **964/103**/23.7.2015 i GjRrGj Fier